



FEMART 9



F. SEXISM
01-06
OCT

© Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis - 2020 / © Art and Community Center - Artpolis - 2020

Autore / Author: Gresa Rrahmani

Dizajn / Design: Arbër Matoshi / KomitetiStudio

Ky botim është bountuar në kuadër të Festivalit Femart. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës për Art dhe Komunitet - Artpolis dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret për të pasqyruar pikëpamjet e donatorëve tanë.

This publication was published as part of the Femart Festival. The contents of this publication are the sole responsibility of the Center for Art and Community - Artpolis and can in no way be taken to reflect the views of our donors.



FEMART 9

F . . . SEXISM
01-06 OCTOBER

PËRMBAJTJA

DITA 1

SFILATË MODE “ VJESHTA21 - SEKSIZMI” / KS 8

KONCERT “KTHIMI TE RRËNJËT” / BELG - KS 9

DITA 2

PUNËTORIA “FEMINIZMI, MODERNIZMI & NDRYSHIMI” / SHBA - KS 10

PODCAST “ME ART KUNDËR SHTYTPJES?” / KS 11

EKSPOZITA “BREATHE” / SHBA – KS 12

PERFORMANCË ARTISTIKE - ONLINE “MARIGONA NUK E QËNDIS MË FLAMURIN” / KS 14

PERFORMANCË TEATRALE “DITËLINDJA” / KS 15

DITA 3

PODCAST “ÇKA JU KA BO PANDEMIA?” / KS 16

SHFAQJA E FILMIT “THE EICHMANN PROJECT - TERMINAL 1” & DISKUTIM / IZR 17

SHFAQJA E FILMAVE “NEO & DOKU FILMAT” / KS 18

SHFAQJA E DOKUMENTARIT “ASKUSH NUK KA NEVOJË PËR TË” / SRB 20

SHFAQJA E FILMIT “KATËR NËNAT” / IZRAEL 21

SHFAQJA E FILMIT “ZGJOI” / KS 22

DITA 4

PUBLIKIM I RAPORTIT HULUMTUES & KONFERENCA “ADRESIMI I SEKSIZMIT, NGACMIMIT DHE NGACMIMIT SEKSUAL NË KOSOVË” / KS 24

PUNËTORIA “ÇFARË ËSHTË SEKSIZMI DHE SI TA NJOHIM ATË NË JETËN E PËRDITSHME DHE MEDIAT” & “TEKNIKAT E TEATRIT BASHKËKOHOR” / SRB 25

MURALI “SHQIPONJA DYKRENARE” / KS 26

MBRËMJA PËRKUJTIMORE “ARTISTET QË NA MUNGOJNË” KUSHTUAR NEXHMIJE PAGARUSHËS, LEZE QENËS, SHAHINDERE BËRLAJOLLIT, VIOLETA REXHEPAGIQIT / KS 27

SHFAQJA E PERFORMANCËS “GJUNETARET E ARTEMIDËS” / KS 29

DITA 5

PUNËTORI PËR VETËMBROJTJE “ÇIKAT E SJELLSHME” / KS 30

PODCAST “ART PËR SH’NET” / KS 31

PERFORMANCA TEATRALE “DETI/GRUAJA” / MB-SRB 32

MBRËMJA E PROMOVIMIT TË LIBRIT DHE POEZISË “SHKRIMI SI NJË MJET PËR TË SHKATËRRUAR PATRIARKATIN” / SHQIPËRI – KOSOVË - SHBA 33

PERFORMANCË DANS TEATËR “TOTEM DHE TABOO” 35

DITA 6

YOGA “YOGA ASANA DHE PRANAYAMA” 37

PODCAST “QYSH BOHET MA E MIRË E NESËRMJA?” / KS 38

NATA E KABARESË FRANCEZE / KS 39

DANS PERFORMANCA “TAONURA” / EGJIPT 41



PËRSHËNDETJE NGA DREJTORESHA E FEMART, ZANA HOXHA.

BASHKË KUNDËR SEKSIZIMIT!

Të dashur artiste/ë, aktiviste/ë, shoqe e shokë FemArt 9 sivjet vjen si hapësirë për reflektim mbi normat gjinore të krijuara në shoqërinë tonë përgjatë dekadave, që shpesh përbën hapësirë për dhunë e pabarazi.

Shtypja e shfrytëzimi i grave duhet të ketë një fund. Rruga nuk është aspak e lehtë për këdo që do drejtësi e barazi, edhe gjinore, por ne e duam lirinë dhe jetën. Këtë e shprehim përmes artit tonë, një proteste, një shfaqje teatrore, një performance, përmes poezisë e konferencave, për të ngritur zërin për vete e t'i japim dorën edhe atyre që duan të bashkohen në rrugëtimin tonë drejt çlirimit.

Ndaj FemArt 9 vjen nën moton “F... Seksizmit” si thirrje për shoqëri të barabartë gjinore. Aty ku secila prej nesh mund të jemi vetvetja, duke guxuar, duke rrëzuar barriera e tabu se si perceptohemi si gra. Kjo është vetëm vazhdimësi e rrugëtimit që artiste/ë, aktiviste/ë para nesh e kanë nisur për të na liruar nga zinxhirët e patriarkatit. E këta zinxhirë ne, si feministe/ë, duam ta bëjmë edhe më të lehtë për gjeneratat e ardhshme duke iu hequr hallkat, deri në mosekzistencën e tyre.

Siç e ka thënë edhe bell hooks, “...feminizmi është një lëvizje për t'i dhënë fund seksizmit, shfrytëzimit seksist dhe shtypjes”. Prandaj, vetëm të bashkuara mund t'i japim fund seksizmit, të cilin patriarkati e imponon në nivel ekonomik, politik e kulturor.

Duke ju uruar mirësardhje në FemArt 9, ju ftojme ta ndiqni fizikisht dhe online programin tonë artistik për gjashtë ditë radhazi, 1-6 tetor, 2021.

Vaksinohu e hajde n’FemArt!

Zana Hoxha

Themeluese dhe Drejtore Ekzekutive e Artpolis dhe FemArt



FEMART 9

01-06 TETOR
PRISHTINË
REPUBLIKA E KOSOVËS

Hej, F... Seksizmit, edhe tung

Si ekip, kolektiv, njerëz diversë, gra, e në veçanti si pjesë e platformës unifikuese siç është Artpolis, ne jemi të lumtur t'iu njoftojmë se edicioni i ri i Festivalit FemArt po vjen. Festivali FemArt është platformë ku artistët/artistet dhe aktivistët/aktivistet mblidhen për të revolucionarizuar artin ashtu që të transformojmë status quo-në duke shkatërruar normat e strukturat patriarkale. Por, ne gjithashtu transformojmë atë që ka filluar për një të tashme të jetueshme dhe një të ardhme më të mirë.

Përgjatë edicioneve tona të kaluara nuk është që ne thjeshtë kemi destabilizuar, por gjithashtu kemi shkatërruar status quo-të, normat dhe strukturat e dëmshme. Progresi nuk është asnjëherë i lehtë. Por, siç thotë Rosa Luksemburg: **“ata që nuk lëvizin, nuk i vërejnë zinxhirët e tyre”**. Ne si ekip i Artpolis dhe organizatorë/e të FemArt jemi të përkushtuar/a t'i këpusim zinxhirët. Deri kur edhe hallka e fundit shtypëse të shpëputet dhe shkatërrohet në copëza, derisa zinxhirët tanë të mos zhduken, lufta jonë nuk ka përfunduar.

Ky vit ka qenë plot humbje jetësh, humbje ekonomike, trazira shpirtërore dhe emocionale. COVID-19 e ka bërë jetën më të vështirë në çdo dimension të mundshëm dhe njëkohësisht ka shfaqur logjikën dhe mekanizmat e kalbur të sistemeve aktuale shtypëse. Seksizmi, racizmi, queerfobia ndër të tjera shkaktojnë vdekje. Sikur të mos mjaftonte pandemia globale, lajmet për dhunën seksuale, dhunën në familje dhe diskriminimin në vendet e punës, në institucionet arsimore, në rrugë dhe brenda shtëpive na kanë shqetësuar të gjithëve. Këto fenomene na kanë revoltuar dhe në të njëjtën kohë nxitur për të krijuar e vepruar. Seksizmi dhe shtypja kanë qenë këtu për një kohë të gjatë tashmë, dhe padyshim që nuk ka qenë një kohë e këndshme.

Ne jemi këtu për të qëndruar, kështu që **“F... Seksizmit”**. Ne besojmë në barazi në mes njerëzve. Ne njohim, pranojmë, çmojmë, festojmë dhe mbështesim dallimet. Ne qëndruam në solidaritet me njëri-tjetrin në edicionin tonë gjatë vitit të kaluar. Ishte kohë reflektimi, mirësie dhe kujdesi më shumë se gjithçka tjetër. Këtë vit fuqia jonë krijuese është thirrur në veprim për të luftuar padrejtësitë në emër të dallimeve gjinore. Artistë/e dhe aktivistë/e nga komunitetet lokale dhe ndërkombëtare do të mblidhen për të provokuar, frymëzuar dhe sfiduar në çdo mënyrë të mundshme realitetet aktuale seksiste. Nga shfaqjet, poezitë dhe vallëzimet, diskutimet dhe konferencat, deri në neja dhe rebelime, ne do të trajtojmë të drejtat e grave si të drejta të njeriut

DITA 1

SFILATË MODE " VJESHTA21 - SEKSIZMI" / KS

📅 **Data:** 01 TETOR, 2021 – E PREMTE

🕒 **Ora:** 19:30 – 20:00

📍 **Vendi:** TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS & LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

DIZAJNERE: YLLKA BRADA

"VJESHTA 21 - SEKSIZMI"

"Vjeshta 21 - Seksizmi" nga Yllka Brada, duke thyer normat gjinore në modën e përditshme.

Ashtu siç është shprehur artistja: *"Ne jetojmë në një kulturë seksiste, përballja me sistemin e prishur të gjinisë në modë mund t'ju bëjë lehtësisht cinikë, por ka veprime që mund të ndërmarrim për të bërë ndryshime në një mënyrë apo tjetër, pavarësisht nëse jeni stilist i modës apo konsumator. Ju keni të drejtë të vishni çdo gjë që ju pëlqen, të vishni kështu, në këtë koleksion, ne vendosëm të përdorim detaje 'feminine' në veshjet e 'burrave' dhe të kundërtën, detaje 'maskuline' në veshjet e 'grave' gjë që krijon një pamje shumë të rehatshme, seksi dhe 'cool' për të gjithë. Koleksioni ka 30 veshje për të dy gjinitë dhe shumica e tyre janë UNISEX."*

YLLKA BRADA

Yllka Brada është disajnatore e modës, kostumografe dhe stiliste e njohur, e cila punon dhe vepron në fushën e modës dhe si kostumografe tash e 15 vite.

Përfundoi Fakultetin e Arteve në UP në degën Skenografi dhe Kostumografi, në Institutin Francez të Modës në Shkup, si dhe e certifikoi diplomën në Paris në këto dy fusha.

Është e punësuar në Teatrin Kombëtar të Kosovës në pozitën e Kostumografes, si dhe ka brendin e saj të quajtur YLLKABRADA me të cilin: u prezentua 3 herë në Javën e Modës në Shkup, ishte mysafire speciale në Javën e Modës në Mal të Zi, mori çmimin në BIG SEE në Lubjanë, Slloveni, gjatë LondonFashionWeek ishte e ftuar nga Oxford Fashion Studio që të prezantojë koleksionin e saj 'YOU'.



KONCERT "KTHIMI TE RRËNJËT" / BELG - KS

📅 **Data:** 01 TETOR, 2021 - E PREMTE

🕒 **Ora:** 20:15 – 21:00

📍 **Vendi:** TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS &
LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART &
NË FACEBOOK

Këngëtare: CEYLAN TACI

Piano: ALZAN GASHI

Kitarë: ARBËR SALIHU

Bateri: DRIN TASHI

"KTHIMI TE RRËNJËT"

"Kthimi te rrënjët" është një udhëtim i artistes nëpër Ballkan, prej nga ka ardhur, por edhe një udhëtim i brendshëm i saj. Performanca e saj muzikore prezantohet në katër gjuhë, me tinguj ballkanik dhe 'ritme të xhazit', duke krijuar ambient të ngrohtë për audiencën dhe duke përçuar emociione të cilat nuk njohi kufij gjuhësorë".

CEYLAN TACI

Kantautore, autodidakte, e lindur në Bruksel dhe me origjinë shqiptare. E inspiruar në kulturat ballkanike që në rininë e saj, të kënduarit, ritmet dhe vallëzimi janë pjesë e jetës së saj të përditshme.

Përveç burimeve të saj muzikore shqiptare Ceylan eksploron ritmet afrikane, xhaz dhe këngë botërore. Dashuria e saj për ritmet dhe zakonet reflektohet në kompozimet e saj. Tekstet e saj në shqip, anglisht dhe turqisht zbulojnë një univers shumë personal.

ALZAN GASHI

I lindur më 1991 në Prizren. Krahas shkollës fillore të përgjithshme përfundoi edhe shkollën fillore të muzikës, në degën e pianos, atë mesmen në shkencat e përgjithshme, kurse arsimimin universitar në piano, në klasën e profesoresh Lule Elezi. Ai ka marrë pjesë në klasa të ndryshme master me pianistë me famë botërore ku vlen të përmendet Hegedus Endre. Aktualisht është duke kryer master në piano në Universitetin e Prishtinës. Gjatë këtyre katër viteve të arsimimit universitar, ai ka marrë pjesë në shumë koncerte dhe festivale muzikore.

ARBËR SALIHU

Arbër Salihu është kompozitor, kantautor, multi-instrumentist dhe producent nga Prishtina, Kosovë. Ai ka qenë aktiv në muzikë që nga viti 2013, duke bashkëpunuar me Cute Babulja, Genc Salihun, Edona Vatocin duke qenë bashkë-udhëheqës në Oborri, me të cilët lëshoi albumin debutues të titulluar në vitin 2017, përfshirë katër videoklipe. Ai është gjithashtu një kompozitor i vlerësuar me çmime për film dhe teatër, dhe kohët e fundit ka kompozuar muzikë për fëmijë për platformën edukative "Planeti i Fëmijëve". Pjesa e tij klasike "Variacionet në Luleborë" është botuar në "Antologjia e kompozitorëve të rinj kosovarë" në vitin 2020.

DRIN TASHI

I lindur në një familje muzikantësh, Drin Tashi është rritur i rrethuar me instrumente muzikore, dhe ka filluar të merret me muzikë qysh në moshë të re. Disa prej projekteve kryesore ku ka marrë pjesë janë shfaqjet teatrale të prodhuara nga Qendra Multimedia, Teatri Kombëtar i Kosovës, Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet, Kosovo is Everywhere, ku në secilin prej tyre ka punuar në muzikë për shfaqje. Ndër tjerash ka qenë edhe pjesë e grupeve të ndryshme muzikore si Hithat, Zhaba dhe së fundmi projekti i tij kryesor është grupi SYTË, ku kontribuoi si kompozitor, producent dhe instrumentist. Me këto projekte ka udhëtuar rajonin dhe një pjesë të madhe të Evropës duke performuar muzikë në skena të ndryshme siç janë: Pop-culture Festival, Sunny Hill Festival, Localize Festival, Vidy Theatre Lausanne, Piccolo Teatro di Milano, etj.



PUNËTORIA “FEMINIZMI, MODERNIZMI & NDRYSHIMI” / SHBA - KS

 **Data: 02 TETOR, 2021 - E SHTUNË**

 **Ora: 10:00 – 14:00**

 **Vendi: TEATRI ODA**

Trajnere: SHQIPE MALUSHI

FEMINIZMI, MODERNIZMI & NDRYSHIMI

Do të shikojmë themelet e feminizmit, çfarë çoi në kërkesën për ndryshim, ku ishin gratë në fillim të shekullit. Ne do të shikojmë pabarazitë dhe do të reflektojmë se ku jemi tani ne si gra në botën moderne. A ka ndryshuar koncepti i feminizmit me modernizmin? Cilat janë disa vlera transparente që kanë kaluar nga feminizmi? A i ka arritur feminizmi qëllimet e tij? Apo kanë ndryshuar qëllimet me kalimin e kohës? Ne do të diskutojmë përmes dialogut; punës në grup dhe punës me partnerë. Rezultatet e pritshme janë që të kuptojmë thelbin e feminizmit dhe si ta rrisim atë përmes modernizmit duke sjellë ndryshime pozitive dhe barazi.

SHQIPE MALUSHI

Shqipe Malushi është një shkrimtare, poete, interpretese, folëse publike, këshilltare gjinore, një trajnere e fuqizimit dhe trajnere e lidershipit, duke përdorur tregimin për të rritur ndërgjegjësimin, ndërtimin e lidershipit dhe ndërtimin e paqes përmes çështjeve ndërkulturore. Me origjinë nga Kosova, ajo lëvizti duke u transformuar nga një emigrante në një qytetare botërore.

Tregimet e saj janë botuar ndërkombëtarisht dhe përfshijnë një libër me poezi “Për Ju”, në shqip; dhe “Dhurata e Profetëve” në anglisht; “Sekreti i ëndrrave” dhe “Përtej mureve të tokës së harruar, përralla mitologjike shqiptare siç tregohet nga gjyshja e saj!” etj., Puna e saj për fuqizimin e grave u zgjerua përtej kufijve duke forcur marrëdhëniet në Afganistan, Liban, Irak, Indi, Kosovë, Shqipëri dhe SHBA. Ajo është njohur dhe shpërblyer në shumë çmime ndërkombëtare.



PODCAST “ME ART KUNDËR SHTYPJES?” / KS

📧 **Data:** 02 TETOR, 2021 - E SHTUNË

🕒 **Ora:** 12:00 – 13:00

📍 **Vendi:** LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Autore: URESA AHMETI

Folësit: DONIKË AHMETI, EDON SHILEKU & BLERTA ZEQRIRI

Cilat janë motivet për të bërë art për disa artiste/ë? Ku takohen arti dhe aktivizimi? A ka art jopolitike? Në çfarë mënyra është arti platformë për rezistencë? Këto e shumë pyetje të tjera i adresojnë tre artistët e ftuar prej përvojave personale.

URESA AHMETI

Uresa studion Sociologji dhe Studime Feministe, Gjinore dhe Seksualitetit në Universitetin Ueslejan (Wesleyan), në Konektikat të SHBA-së. Si shkrimtare, aktiviste dhe artiste e performancave konceptuale, ajo gjithmonë e ka parë artin dhe aktivizmin si gjëra të pashkëputura nga njëra-tjetra. Prej bërtimisë së poezisë performuese (slam) në protestat kundër deportimeve në Holandë deri te performanca e pjesëve origjinale në Festivalin FemART në Evropën Juglindore, ky kombinim i artit dhe aktivizmit i ka dhënë formë rrjedhës së jetës së saj. Ajo është autore e drag performances “A je çikë, a djalë?”, gjithashtu ishte pjesëmarrëse në FemArt me dy performanca “From ‘Other’ to ‘Self’ dhe “Interrogating Power”. Ajo botoi librin e saj të parë me poezi “Qysh me Abortu Drejtin” në Gusht të këtij viti. Projektet e saj kanë gjithmonë feminizmin dhe ndryshimin e shoqërisë shtypese në fokus.

DONIKË AHMETI

Donikë Ahmeti është aktore, performuese, producente, aktiviste. Ka luajtur me dhjetëra shfaqje teatrale duke bashkëpunuar me shumë regjisorë/ë vendorë dhe të huaj. Donika është mjaft aktive edhe në skenën televizive.

EDON SHILEKU

Edon Shileku, 24 vjeçar, aktor me profesion. Ka vijuar shkollën fillore të muzikës “Prenk Jakova” për piano që nga klasa e tretë. Skenën e sheh si platformë për dëfrimin e emocioneve të brendshme që shpesh në jetë nuk mund t’i shprehë. Aktivizmi është pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së tij kryesisht mbi bazat e barazisë në çdo formë, qofshin ato etnike, fetare, gjinore apo racore. Përmes artit synon ndryshimin e pikëpamjeve fanatike mbi konceptet primitive që shoqëria i ka strukturuar. Kjo bëri që ai të merrej me Drag, duke marrë parasysh që personat e komunitetit LGBTI+ janë njëri nga grupet më të shtypura në vendin tonë.

BLERTA ZEQRIRI

Blerta Zeqiri, e lindur më 06.06.1979 në Prishtinë, kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Suhareke. Është reperja e parë shqiptare e cila në vitin 1994, si adoleshente ka filluar të publikojë muzikë hip hop me grupin e saj BAM. Blerta si refugjate shkoi në Francë ku i filloi studimet për film në universitetin Paris 8. Nga viti 2002 deri më tani Blerta punoi shumë filma të shkurtër të cilët u shpërblyen shumë herë në festivale të filmit. Ndër shpërblimet më të rëndësishme vlen të përmendet shpërblimi për filmin më të mirë të shkurtër në Sundance, SHBA.

Filmi i saj i parë i metrazhit të gjatë u shpërblye me dy çmime në festivalin e kategorisë A në Estoni “Tallinn Black Nights”. Është ky filmi i parë i metrazhit të gjatë në Kosovë me tematikë komunitetin LGBTI+.

Në vitin 2018, Blerta Zeqiri u shpërblye nga Ministria e Kulturës me çmimin vjetor për kinematografi dhe filmi i saj “Martesa” ishte kandidati i Kosovës për garën Oscar 2019. Blerta është anëtare e Akademisë Evropiane të Filmit dhe është dekoruar nga shteti i Francës me urdhërin “Kalorëse e urdhrit të artit dhe letërsisë”.



EKSPOZITA “BREATHE” / SHBA – KS

📅 **Data:** 02 TETOR, 2021 - E SHTUNË

🕒 **Ora:** 18:00 – 18:30

📍 **Vendi:** GALERIA E FAKULTETIT TË ARTEVE & LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Kuruar nga: BERAT BAJRAMI

Artistët pjesëmarrës në ekzpozitë: ELLEN FRANK, RENEA BEGOLLI, ANI MANANA MATEVOSSIAN, BUTRINT MORINA, LARA SAGET, LUIZA THAQI, LUMTURIE KRASNIQI, RAGINI UPADHYAYA, BERAT BAJRAMI, SUZANNE WIND GASKELL.

Instalues: SKENDER XHUKOLLI

Ekspozita “Breathe” nderon jetën si tërësi, e shenjtëron atë, e si rrjedhojë ju përkulet shpëtimtarëve. Ekziston një problem i përbashkët, për pasojë ekziston një bashkësi e arteve. Fryma është përbashkuese. Abstraktja bëhet dëshmi, bëhet e paraqitshme ajo që ishte e padukshme. Gjërat marrin kuptim tjetër, ndoshta të plotë në kohë izolimi. Ndonjëherë lindja e ka kundrejt vdekjen dhe e kundërta. Shkëputja është vazhdimësi dhe makthi shpesh bëhet realitet. Është kohë pandemie, çiftëzimi bëhet njëzim, kur lëvizja ndalon por vetëm për disa momente. Prapëseprapë forca të mbërthen, dhe gjithçka fillon e rrjedhë edhe njëherë si mëparshëm.

BERAT BAJRAMI

Berat Bajrami ka lindur më 1990 në Rahovec. Ai ka përfunduar masterin në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës në degën e Grafikës. Për më shumë se pesë vjet ka punuar si gazetar në Grupin KOHA, derisa paralelisht është angazhuar në projekte artistike e kulturore.

Më 2020 ka vazhduar me angazhimin e tij artistik me fokus në temat si: trashëgimia kulturore e çështjet e ambientit.

Në prill, 2020 ka realizuar ekspozitën personale “Lidhja” në të cilën ka trajtuar fatin e trashëgimisë kulturore të Kosovës – artefakteve, që aktualisht po mbahen peng në Serbi. Kurse në dhjetor ishte pjesë e ekspozitës kolektive “Given” nga Fondacioni 17, në të cilën janë trajtuar çështjet emergjente të ambientit. Në këtë ekspozitë është prezantuar me veprën “Ishulli i Lumturisë”.

Nga marsi 2021 është pjesë e Artpolisit si koordinator i projekteve.



Cikllit i Jetës

ELLEN FRANK

Artistja, studiuesja dhe shkrimtarja, Ellen Frank ka marrë shumë çmime në pikturë, hartimin e librave dhe bursa, përfshirë Fulbright Fellowship, National Endowment for the Arts, Ford Foundation Fellowship, Pollock Krasner Award in Painting, New York State Council on the Arts, dhe një grant nga Fondacioni i New York-ut për Arte. Në vitin 2018, Dr. Frank u emërua Fulbright Specialist në Ndërtimin dhe Pajtimin e Paqes, Byroja e Departamentit Amerikan të Shtetit për Çështjet Arsimore dhe Kulturore (ECA) dhe Mësimi Botëror, dhe mori një Çmim për Përsosmëri për Qytetet e Paqes nga KFOR / NATO.

Më 2004, Dr. Frank themeloi "Ellen Frank Illumination Arts Foundation, Inc.", një organizatë globale jofitimprurëse kushtuar fuqisë transformuese të artit për të ndërtuar një kulturë mirëkuptimi dhe paqeje. "CITIES OF PEACE ILLUMINATED" është nisima e saj kryesore. Si drejtoreshë artistike, Dr. Frank ka trajnuar praktikantë artistë nga më shumë se 52 vende, derisa bashkon studiues dhe ekspertë për të punuar në krijimet e përbashkëta.



"Song of the Downy Woodpecker"

RENEA BEGOLLI

Renea Begolli (1998) është një artiste vizuale nga Prishtina, Kosovë. Në vitin 2021, ajo diplomoi për Pikturë (Bachelor), në Fakultetin e Arteve, Universiteti i Prishtinës. Në të njëjtin vit, ajo vazhdoi studimet në Universitetin Bournemouth, në Sociologji dhe Antropologji Sociale në Bachelor, në programin e shkëmbimit për një semestër përmes Erasmus+.

Idetë e saj shprehen kryesisht përmes pikturave, vizatimeve, instalacioneve dhe video-artit të inspiruara nga kujtesa personale dhe kolektive ndaj temave të ndryshme shoqërore, veçanërisht mbi izolimin dhe mungesën e lirisë së lëvizjes në hapësirën mendore dhe fizike në Kosovë.



"Ballkoni"

ANI MANANA MATEVOSSIAN

Ani Manana Matevosian është arkitekte nga Jerevani, Armeni. Aktualisht ajo jeton në Sofje, Bullgari. Ani ka marrë pjesë në shumë projekte që bashkojnë artin dhe paqen, pasi e bëri prioritet të jetës dhe punës së saj. Aktualisht ajo po vazhdon studimet e saj për të mësuar më shumë rreth Arkitekturës Biometrike pasi është një shembull se si ndikon natyra në shoqëri dhe fuqia që ka është e pamohueshme.




"Shpresa"

BUTRINT MORINA

Butrint Morina i lindur më 1988 në Gllarevë të Klinës, ka përfunduar studimet në degën

e arteve figurative, drejtimi Skulpturë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Aktualisht punon si skulptorë i lirë, derisa është menaxher i AIESM (Asociacioni Ndërkombëtar i eventeve për skulpturën monumentale për Kosovë), anëtar i ISSA-së (Asociacioni ndërkombëtar i simpoziumeve të skulpturës). Morina ka realizuar tri ekspozita personale në Kosovë, derisa ka qenë pjesëmarrës në dhjetëra ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Ka fituar gjashtë çmime vendore dhe ndërkombëtare. Derisa ka qenë pjesë e shumë simpoziumeve ndërkombëtare të skulpturës në: Turqi, Egjipt, Iran, Izrael dhe Maqedoni Veriore.



"Ajo"

LARA SAGET

Lara Saget (lindur më 1989) jeton dhe punon në New York, NY. Ajo diplomoi në Kolegjin Barnard, Universiteti Columbia dhe master në Artet e Bukura në Universitetin e New York-ut. Puna e saj është ekspozuar në SHBA dhe jashtë saj në vende dhe hapësira të ndryshme.

Lara bashkëthemeloi Studio 200, një koleksion ekspozite arti në të cilën shfaqjet e kuruara përkohëni tematikisht me punëtori, ligjëratat dhe instalime të mediave të ndryshme.



"Duke u varur në një fije"

LUIZA THAQI

Luiza Thaqi është një artiste e re që jeton në Kosovë. Ajo është në përfundim të studimeve në Fakultetin e Arteve, Universiteti i Prishtinës, departamenti i pikturës. Si artiste vizuale ajo punon me një shumëllojshmëri të mediave, përfshirë pikturën, vizatimin, fotografimin dhe videon.

Puna e saj shpesh lidhet me përvojat personale, por si e tillë të trajtohet në kontekstin e përbashkët të të qenurit, në kushit, pasi faktori i këtyre përvojave vjen nga të qenit në një gjendje të përbashkët me rrethanat.



"Gjenerimi përmes nevojave të reja"

LUMTURIE KRASNIQI

Lumturie Krasniqi i lindur më 1997 në Prishtinë. Aktualisht është duke vazhduar

studimet master në pikturë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës.

Praktika e saj e punës është e fokusuar në simbolet dhe strukturën përmes së cilës ajo përpqet të lexojë veten dhe të paraqesë temën me të cilën merret. Dy nga simbolet që gjenden më shpesh në veprat e saj janë rrethi dhe katrori. Ajo i sheh këto dy simbole si paralele që ndërveprojnë me njëri-tjetrin, nga ana tjetër si të kundërta.



"Të tria unë"

RAGINI UPADHYAYA

Ragini Upadhyaya (lindur më 1959) është një artiste e mirënjohur nepaleze dhe (ish) kancelarja e parë e grave nepale në Akademinë e Arteve të Bukura të Nepalit. Ajo u diplomua për Arte të Bukura në Kolegjin e Arteve Lucknow, Indi më 1982, dhe mori bursën e Këshillit Britanik për grafikë në 1987 - 88 në Peacock Printmakers, Aberdeen, Skoci dhe Oxford Printmakers, Oxford, Britani.

Ajo ka fituar disa çmime vendore dhe ndërkombëtare në grafikë përfshirë çmimi në Gjermani, Britani, Finlandë, Pakistan e Indi.




"Corona Safety Tools"

SUZANNE WIND GASKELL

Suzanne Wind Gaskell (lindur në 1958) është drejtuese e Departamentit të Artit të Shkollës së Mesme Daniel Hand në Madison, SHBA.

Ajo ishte një nga fitueset e Çmimit Fuqia e Artit 2008, e sponsorizuar nga Fondacioni Robert Rauschenberg në lidhje me Shkollën Lab në Uashington, DC, për projektet e saj inovative të klasës. Ajo mbetet e përkushtuar për të fuqizuar studentët për të krijuar art që i përgjigjet ngjarjeve aktuale dhe promovon mirëkuptimin ndërkulturor.



"Transformimi dhe shërimi"



PERFORMANCË ARTISTIKE - ONLINE "MARIGONA NUK E QËNDIS MË FLAMURIN" / KS

📅 **Data:** 02 TETOR, 2021 – E SHTUNË

🕒 **Ora:** 18:40 – 18:50

📍 **Vendi:** LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Artiste: SARANDA SADIKAJ – MS. INDEFINITE

Performanca "Marigona nuk e qëndis më flamurin" në mënyrë artistike e kreative adreson dhunën, vrasjen, plagët, sakrificat, luftën për drejtësi dhe rezistencën e grave në një vend ku dita e nesërme e jetës së tyre gjithnjë është në pikëpyetje. Historikisht në trojet shqiptare dihet se graja që e qëndisi flamurin quhej Marigona, kështu duke i dhënë kuptim heroiko-simbolik performancës, duke goditur në mënyrë metaforike që vajza që u vra e quajtur Marigona "nuk e qëndis më flamurin". Artistja Ms. Indefinite në këtë rast qëndron te gjykata ku është e hapur 'e pamja për kryeshnosh' deri në ditën e shqiptimit të dënimit me burgim të përjetshëm të vrasësit, me qëllim që të ngritë vetëdijen tek audiencia që vrasësi duhet dënuar dhe institucionet duhet të marrin përgjegjësi për të përfillur punën e tyre. Në këtë mënyrë duke shprehur revoltë për një jetë me të drejta të barabarta ku gratë nuk cilësohen vetëm numër por qenie njerëzore. Performanca "Marigona nuk e qëndis më flamurin" është zhvilluar te Gjykata në Ferizaj për rastin specifik të Marigona Osmanit e cila u dhunua mizorisht dy dite rresht dhe në fund u vra nga partneri i saj Dardan Krivaqa.

**SARANDA SADIKAJ –
MS. INDEFINITE**

Ms. Indefinite është artiste feministe, që më anë të aktivizmit të saj artistik, përmes video-përformancave/ instalacioneve avokon për të drejtat e gruas në Kosovë.

Nëpërmjet artit si krijim shpreh kritiken shoqërore duke shfaq revoltën qytetare në krijimtarinë artistike. Ajo trajton në menyrë kreative dhe në formë goditëse çështjen e drejtësisë dhe barazisë gjinore në shoqërinë Kosovare, me synimin e luftimit artistikisht të patriarkatit dhe femicidit.

IGOR MARTINIC

DITËLINDJA

DJALI IM VETËM ECË PAK MË NGADALË

REGJIA: ILIRJANA ARIFI

TEATRI I QYTETIT TË PRISHTINËS
DODONA

PERFORMANCË TEATRALE "DITËLINDJA" / KS

📅 **Data:** 02 TETOR, 2021 – E SHTUNË

🕒 **Ora:** 19:00 – 20:15

📍 **Vendi:** TEATRI DODONA & LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Regjisore: ILIRIANA ARIFI

Aktorë/e: IGBALLE QENA, REBEKA QENA, BISLIM MUÇAJ, ALKETA SYLAJ, SHEQERIE BUQAJ, FLORENTA BAJRAKTARI, LABINOT RACI

"Çdo familje e lumtur ngjan në njëra-tjetrën e çdo familje e palumtur është e palumtur në mënyrën e vet. Kjo ndodh edhe në familjen e Mias. Në këtë dramë ku problemet fillojnë qysh më herët, kur djali fillon të ketë probleme me ecjen, sëmundje e cila rritet gradualisht deri në momentin kur bëhet i palëvizshëm dhe i nevojitet karroca. Ngjarja ndodh brenda një dite, kur është edhe ditëlindja e tij, dhe ne shohim brengën familjare, e cila më së shumti reflektohet te nëna, e cila nuk mund ta pranojë ende faktin se djali i saj nuk ec'."



ILIRIANA ARIFI

Në vitin 2000-2001 regjistroi Fakultetin E Arteve në Universitetin e Prishtinës, dega Regji Teatri, me 15.06.2005 diplomoi me shfaqjen "Emigrantet"- Slavomir Mrozhek ne Teatrin e Pejës.

Regjistruar ne vitin akademik 2009/2010,ka mbrojtur tezen e studimeve Master,me date 20.10.2010,me teme-shfaqjen 'Dardha pas bunari'ne Etno-teater-KUKAJ.

Ka inskenuar rreth 20 shfaqje profesionale në teatro të ndryshme të Kosovës, duke fituar disa çmime të rëndësishme.

DITA 3 PODCAST “ÇKA JU KA BO PANDEMIA?” / KS

📅 **Data:** 03 TETOR, 2021 – E DIEL

🕒 **Ora:** 12:00 – 13:00

📍 **Vendi:** LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Autore: URESA AHMETI

Folëse: ZANA HOXHA & ROBERT NUHA

Në këtë episod Robert Nuha dhe Zana Hoxha ndajnë përvojat e tyre gjatë pandemisë. Veçanërisht ata fokusohen në punën me shfaqjen e vetme të realizuar gjatë pandemisë “Zgjimi i Pranverës”; në këtë episod mund të dëgjoni më shumë rreth sfidave emocionale, fizike e logjistike.



ZANA HOXHA

Themeluese / Drejtoreshë e Artpolis dhe FEMART Festivalit
Zana Hoxha (e lindur më 1981) është regjisore profesionale e teatrit, themeluese dhe drejtoreshë ekzekutive e Qendrës për Art dhe Komunitet – Artpolis, organizatë kjo që promovon artin dhe diveristetin me dialog social dhe integrim të komunitetit.



ROBERT NUHA (NOA)

U lind në Komoran (Rks) 1990. Karrierën e filloi me kërcime urbane, hip hop, breake dans, si dhe me valle popullore shqiptare. U diplomua në Koreografi, Bachelor 2016 dhe Master 2019 në Universitetin e Arteve në Tiranë (AI).

Aktualisht Profesor i Koreografisë dhe Dansit Bashkëkohorë pranë Kolegjit AAB- Prishtinë. Koreograf i Trupës artistike Rezidente pranë Qendrës “Artpolis” - Prishtinë.



SHFAQJA E FILMIT “THE EICHMANN PROJECT - TERMINAL 1” & DISKUTIM / IZR

📅 **Data:** 03 TETOR, 2021 – E DIEL

🕒 **Ora:** 13:00 – 15:00

📍 **Vendi:** KINO ARMATA

Regjia: LILACH DEKEL-AVNERI

Dramaturgjia: LIAT FASSBERG

Aktorët/et: EFRAT ARNON, MICHAL WEINBERG, KEREN KATZ, DANIEL SAPIR

Kamera kryesore: SASCHA ENGEL

Adaptimi: LILACH DEKEL-AVNERI DHE ANSAMBLI

60 vjet pas njoftimit dramatik të David Ben-Gurion për kapjen e Adolf Eichmann, Pathos Mathos Company rishikon një nga ngjarjet kryesore në historinë e Izraelit-gjyqin Eichmann. Projekti Eichmann - Terminali 1 është një ngjarje skenike shumëdisiplinore - një ritual i rilindjes për kamerën dhe audiencën, duke thirrur zërat që patën jehonë në vitin 1961 në Beit Ha'am (tani Qendra Gerard Behar) në Jeruzalem dhe duke u kthyer në stuhinë publike që ndoqi gjyqin.



LILACH DEKEL-AVNERI

Regjisore teatri, kuratore, përkthuese e dramaturge nga Izraeli. Fituese e çmimit prestigjioz Rosenblum për Artet Skenike, dhe programit të Artistit Vizitor të Institutit Izraelit. Themeluese dhe drejtore artistike i kompanisë teatrore të vlerësuar me çmime, Pathos-Mathos.

Veprat e saj shpesh përshkruhen si “ngjarje teatrale ose vepër arti me cilësi poetike dhe sureale që ofrojnë një alternativë të vërtetë për teatrin konvencional”.

Lilach është menaxhere i komitetit hebraik të rrjetit ndërkombëtar EURODRAM.



SHFAQJA E FILMAVE “NEO & DOKU FILMAT” / KS

 **Data: 03 TETOR, 2021 – E DIEL**

 **Ora: 15:00 – 16:00**

 **Vendi: KINO ARMATA**

Regjisorë/e: VALMIRA RASHITI, REDON KIKA, NOL SAHATÇIU, ANISA KRASNIQI & BARDHA KRYEZIU, VLERA AZIZI, TRINGA BERISHA, ERA SKIVJANI, FLUTURA BALAJ, ENTELA HOXHA

Neo School është shkollë joformale një-mujore për prodhimin e filmave të shkurtë dokumentarë, e organizuar nga Kino Armata, Prishtinë. Vijuesit e kësaj shkolle kanë mundësi të dëgjojnë ligjërata nga profesionistë të njohur të procesit të filmbërjes së dokumentarëve prej produksionit, hulumtimit, zhvillimit të skenarit, regjisë, montazhit, audios, etj. Filmat e prezantuar në FemArt 9, janë rezultat i shkollës Neo-school.

Shkolla e filmit dokumentar DokuFest, është një program trajnues që inkurajon filmbërjen krijuese të dokumentarëve përmes ushtrimeve praktike për tregim vizual, gjersa familjarizon të rinjtë me konceptin e qytetarisë aktive, të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike. Ky program udhëzon dhe nxit të rinjtë të ndër marrin veprime dhe të jenë agjentë aktivë për ndryshimet shoqërore përmes tregimit dhe krijimit të filmit. Disa nga krijimet e shkollës së filmit Dokufest, janë prezantuar në FemArt 9.

VALMIRA RASHITI

Valmira ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik-Universiteti i Prishtinës. Me një bagazh relativisht të gjatë të aktivizimit në shoqërinë civile, Valmira është kurioze me shfaqje aspekte të ndryshme social-kulturore përmes dokumentarëve, me focus në

marrëdhëniet gjinore. Aktualisht është koordinatore e projektit të Rjeti i Grave të Kosovës dhe krijuese e pavarur e shkrimeve.

“Gojë ka, Gojë s’ka”

“Gojë ka, Gojë s’ka” është filmi debutues i regjisores Valmira Rashiti. Filmi 11 minutësh trajton marrëdhëniet e grave dhe vajzave

me veten dhe burrat në jetën e tyre, transformimin të cillin e pësojnë përgjate fazave të ndryshme të jetës, martesën, fëmijët, lirinë e të shprehurit dhe dallimet në dinamika gjinore mes gjeneratave. Në theks, “Gojë ka, gojë s’ka” trajton heshtjen, si “atribut” i cili u është mveshur dhe vazhdon t’u mveshet grave dhe vajzave.

REDON KIKA

Redon Kika është aktor nga Prishtina, i lindur me 11.09.1998. Ai ka studiuar aktrim në Universitetin e Prishtinës dhe ka qenë aktiv në skenën e teatrit dhe filmit që në moshë të re.

“Unë kurrë nuk kam udhëtuar me aeroplan” nga Redon Kika

Tre të rinj nga Kosova të cilët nuk kanë hipur kurrë në aeroplan, diskutojnë se çka do të thotë për ta të mos kenë udhëtuar në asnjë vend tjetër pos Ballkanit. Filmi trajton temën e izolimit dhe liberalizimit të vizave nga sytë e të rinjve kosovarë. Ky film ka fituar dy çmime dhe është shfaqur në disa vende të botës.

NOL SAHAÇIU

I lindur me 07.10.1989, në Prishtinë. Nol Sahaçiu është profesionist i marketingut digjital, me përvojë 8 vjeçare në kompani dhe organizata të ndryshme Kosovare dhe ndërkombëtare. Përveç punës profesionale, ai gjithashtu ka shkrime të publikuara në Prishtina Insight, Kosovo 2.0 dhe Kosovo Diaspora. Së fundmi, Noli ka xhiruar dy dokumentar, një të metrazhit të gjatë, të quajtur “Rikthimi”, dhe tjetrën të shkurtër, “Nji Ditë me Rita Bekqelin”.

“Një ditë me Rita Bekqelin” nga Nol Sahaçiu

Rita Bekqeli është vajzë me aftësi të kufizuar që jeton në Prizren. Ne ecim rreth qytetit dhe diskutojmë për problemet e lëvizjes së të cilat ballafaqohet ajo në qytetin e saj.

ANISA KRASNIQI & BARDHA KRYEZIU

Anisa Krasniqi, e lindur me 06.02.2000, studente në vitin e fundit bachelor. Pasioni i saj është krijimi i filmave dhe fotografia, pasi përmes tyre ajo shpreh realitetin e shoqërisë ku jeton.

Bardha Kryeziu është 17 vjeçare dhe jeton në Prizren. I pëlqen arti e kryesisht filmatografia, sepse mendon që është mënyra më e mirë për ta përballur botën me pasojat e veprimeve të tyre.

“Per hatër” nga Anisa Krasniqi & Bardha Kryeziu

“Për hatër” është dokumentar i shkurt i cili paraqet jetën e një gruaje nga një fshat i Kosovës, problemet e shkaktuara nga burri i saj abuziv, paragjykimet e shoqërisë sonë ndaj gruas dhe si institucionet tona të drejtësisë i trajtojnë rastet e këtyre grave.

VLERA AZIZI

Vlerë Azizi është regjisore premtuese, vetëm 17 vjeçare, nga Gjilani. Studion në UWC Adriatic - Itali.

“Përtej ylberit” nga Vlera Azizi

“Përtej Ylberit” është një dokumentar i shkurtër që përqendrohet në ‘drag-queens’ që bëjnë jetën në Kosovë dhe luftën kundër jotolerancës së vendosur në kryeqytet. Ne ndjekim dy ‘drag-queens’ të njohura në përpjekjen e tyre për të përqafuar personalitetin e tyre të shkëlqyeshëm. Ato gjatë gjithë kohës bëhen gati për performancën e tyre të ardhshme. Gjithashtu duke prekur çështjet e homofobisë dhe prejardhjeve socio-ekonomike, dokumentari përmban biseda midis ‘drag-queen’-eve të njohura Agatha Bones dhe Diva.

FLUTURA BALAJ

Flutura Balaj, 21 vjeçare, është fizikane e diplomuar dhe aktualisht studente master në Astrofizikë dhe Kozmologji në Itali. Ka pasion kinematografisë dhe është videografe në Dokufest.

“Shtojzovalle” nga Flutura Balaj

Krijesa magjike të mitologjisë shqiptare që posedojnë fuqi të mbinatyrshme dhe bukuri të jashtëzakonshme. Shpesh gjenden në pyje duke kënduar dhe kërcyer, Shtojzovalle më në fund kapen nga sytë e njerëzve. Pas shekujsh që jetojnë rreth nesh, ata na ftojnë në realitetet e tyre mistike. Duke na lënë të takojmë superfuqitë e tyre, botën e tyre të bukur dhe dëshirën për muzikë, këto Shtojzovalle na ndihmojnë të reflektojmë për mundësitë e humbura që na është dashur të shohim dhe vlerësojmë ndonjë Shtojzovalle në jetën reale.

ERA SKIVJANI

Është 21 vjeçe dhe vjen nga Gjakova, atje perfundoj shkollimin fillestar dhe gjimnazin «Hajdar Dushi». Tani është studente në vitin e fundit në RIT Kosovo dhe në të njëjtën kohë punon si asistente e marketingut në GSI Associates në Prishtinë. Ka marrë pjesë në shkollën e dokumentarëve nga Dokufest në vitin 2018, ka qenë përvojë e jashtëzakonshme për të dhe ka kontribuar jashtëzakonisht shumë në aftësitë e saj të mendimit kritik dhe shfaqjes së opinionëve në mënyrë artistike.

YLLKA HAXHIKADRIJA

Është 26 vjeçe dhe vjen nga Gjakova, atje perfundoj shkollën fillore dhe atë të mesme. Është arkitekte me profesion, duke ndjekur studimet në nivelin bachelor në fakultetin e arkitekturës në Universitetin e Prishtinës. Ka qenë pjesë e shkollës së dokumentarëve nga Dokufest.

“Pa përkufizim” nga Era Skivjani dhe Yllka Haxhikadrija

“Pa Përkufizim” është film i shkurtër dokumentar i cili tregon historitë e 4 karaktereve të ndryshme. Çështja kryesore që zhvillohet në këtë dokumentar është paragjykimi si një e vërtetë e trishtë e shoqërisë tonë. Qëllim kryesor i dokumentarit në radhë të parë është paraqitja e paragjykimit si fenomen i realitetit të përditshëm, dhe pastaj ngritja e vetëdijësimit për të si dukuri.

ENTELE HOXHA

Entela Hoxha e lindur më 1988 në Gramsh, Shqipëri dhe jeton në Tiranë. Ajo studioi pikturë në Gjimnazin Artistik “Jordan Misja” dhe më pas Multimedia në Universitetin e Arteve të Bukura në Tiranë. Në vitin 2012 Entela ka ndjekur studimet e filmit dhe televizionit dhe tashmë ka përfunduar filmin e saj të parë të shkurtër të animuar, “Nën vellon 1” i cili është realizuar në vendlindjen e saj 2013. Filmi i saj i dytë është nën emrin “ Nën vellon 2 ” realizuar në Prizren 2015. “Donald Trump - Muri i Madh Meksikan” është filmi i saj i tretë animues i realizuar në maj 2017. Entela Hoxha është një artiste vizuale duke sjellë vepra në: pikturë, vizatime dhe film të animuar.

“Nën vello” nga Entela Hoxha

Ajshja është në të njëjtën moshë me gjyshen time dhe historia e Ajshes është pothuajse identike me historinë e shumicës së grave të moshës së saj.

Si ishte martesë për një brez që po shkon?

TRINGA BERISHA

“Kjo është Tringa” nga Tringa Berisha

Rrjetet sociale kanë një vend shumë të rëndësishëm për çdo njeri sot, shumë njerëz bëjnë shumë nga vetja për të postuar një foto ose informacion që herë pas here nuk mund të jetë i vërtetë. Kjo është një histori personale që unë kam ndarë për të transmetuar këtë mesazh.



SHFAQJA E DOKUMENTARIT “ASKUSH NUK KA NEVOJË PËR TË” / SRB

📅 **Data: 03 TETOR, 2021 – E DIEL**

🕒 **Ora: 16:00 – 18:00**

📍 **Vendi: KINO ARMATA**

Skenari dhe regjia: MAJA MITIC

Asistent skenari: DŽENETA AGOVIĆ

**Aktoret: MAJA MITIĆ, DRAGANA JOVANOVIĆ,
ALEKSANDRA PAVLOVIĆ**

**Narratore: OLIVERA VIKTOROVIĆ
ĐURAŠKOVIĆ**

Tri gra, tri fatet, të pafta për të ndryshuar të njëjtit, të cilat janë në kampin e refugjatëve Al Raj në Siri ... Filmi bazohet në histori autentike dhe dëshmi të të afërmeve të viktimave, shtetas serbë të cilët u mbajtën në kushtet më çnjerëzore në kampe në Siri.

Filmi paraqet apelin tonë për qytetarët e Serbisë dhe fëmijët e tyre që janë në kampe në Siri që të lirohen dhe të kthehen në vendin e tyre. Filmi bazohet në histori autentike të mbledhura nga Impulse gjatë vitit 2020.

MAJA MITIC

Maja Mitic (1963) e diplomuar në Akademinë e Artit dhe Dramës (1988), Novi Sad, Serbi.

Për më shumë se 30 vjet duke punuar profesionalisht në teatër si aktore, koreografe, regjisore, krijuese filmi, dramaturge dhe profesoresh vizitore. Themeluese dhe drejtore e Teatrit Ko-smo-s Beograd (2016). Drejtore artistike dhe përzgjedhëse e Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit Jazz Nisville, që nga viti 2017. Që nga viti 2009 profesoresh vizitore në Goldsmiths në MA, Universiteti i Londrës, MB. 2000-01 Profesoresh vizitore në Universitetin e Iowa, SHBA.

DRAGANA JOVANOVIĆ

Dragana Jovanović ka lindur më 1976 në Nish, ku mbaroi shkollën fillore dhe shkollën e mesme. Pas diplomimit, ajo punoi në fakultet si asistente në departamentin e aktrimit që nga viti 2005. Që nga viti 2005 ajo ka qenë anëtare e përhershme e ansamblit të Teatrit Kombëtar në Nish.

Si aktore e ftuar, ajo luajti në Teatrin Kombëtar në Leskovc nga 2000 deri në 2005. Që nga viti 2001, ajo ka luajtur në trupën teatrore “Familja e ujërave të kthjellura”. Ajo është një nga themeluesit e festivalit teatrore Shumes në Rudnik. Që nga viti 2003, ajo është anëtare e skenës së kukullave “Pepino” në Nish.

ALEKSANDRA PAVLOVIĆ

Ajo u diplomua në Akademinë e Arteve BK, në degën e aktrimit, në vitin 2000 me shfaqjen “Shërbëtorët”, nga Jean Genet. Luajti me kohë të pjesshme në Teatrin Kombëtar në Nish, ishte e angazhuar në Teatrin Kombëtar Pirot dhe Teatrin Kombëtar në Leskovc. Po ashtu luajti në disa filma studentorë dhe ishte autore dhe drejtuese e shfaqjes për fëmijë “Alfabeti interesant”, në bashkëpunim me Gendrën Mediatike në Nish. Që nga viti 2012, ajo është anëtare e Teatrit të Kukullave në Nish dhe fitoi çmime të shumta në festivale si brenda dhe jashtë vendit.



SHFAQJA E FILMIT “KATËR NËNAT” / IZRAEL

📅 **Data:** 03 TETOR, 2021 – E DIEL

🕒 **Ora:** 18:00 – 19:00

📍 **Vendi:** KINO ARMATA

Regjisorë: REFAEL LEVIN, DANA KEIDAR LEVIN

Producentë: ADI BAR YOSSEF, REPHAEL LEVIN, DANA KEIDAR LEVIN

Kompania e Prodhimit: BARYO FILM & TV PRODUCTIONS

Bashkëprodhues: GREEN PRODUCTIONS - GAL GREENSPAN, ROI KURLAND AND MAYA FISCHER

Skenari: REFAEL LEVIN, DANA KEIDAR LEVIN, NETA DVORKIS

Redaktimi: NETA DVORKIS

Kinematografia: YANIV LINTON, ADI MOZES

Hulumtimi: HAGIT BEN YAACOV, REPHAEL LEVIN, DANA KEIDAR LEVIN, MAYA KLAR, ALON SAHAR

Zërimi: AMI ARAD

Muzika: KARNI POSTEL

Ky film tregon historinë e herës së parë që një lëvizje civile femërore sfidoi etikën mbizotëruese në historinë izraelite kur nënat për ushtarët protestuan kundër luftës së vazhdueshme në Liban. Është një film për një protestë novatore të grave në një luftë për paqen. Një lëvizje feministe që frymëzoi masat dhe ishte në gjendje t'i jepte fund luftës.

DANA KEIDAR

Lindur në Izrael në vitin 1983. Diplomuar në Sam Spiegel Film & TV School në Jerusalem. Në vitin 2007 ajo drejtoi filmin e shkurtër “Insights”, i cili mori Çmimin e parë të Publikut të Rinj në Festivalin e Filmit Mesdhetar Montpellier në 2008 dhe mori pjesë në festivale të shumta në të gjithë botën.

Në vitin 2011 ajo drejtoi filmin e shkurtër “Stitches”, i cili mori Çmimin e Fondacionit Jerusalem dhe fitoi çmime në festivale në Hong Kong dhe Indi. Çmimi për redaktim në Festivalin Sehnsuchte në Gjermani. Mori pjesë në Festivalin e Filmit në Jerusalem, Festivalin e Filmit Studentor në Tel-Aviv, Festivalin Clermont-Ferrand në Francë, Festivalin Munchen, Festivalin e Filmit Studentor në Puna të Indisë, Festivalin Freiburg në Zvicër, Festivalin e Filmit të Grave në Rehovot, Festivalin e Filmit Studentor në Pekin dhe festivale të tjera të filmit në të gjithë botën.

Në 2019 fitoi çmimin e parë në festivalin e filmit hebre në Toronto, dhe në festivalin e filmit hebre në Boston, gjithashtu dhe çmimin skenari më i mirë në festivalin ndërkombëtar të filmit të shkurtër Clujshorts.

REPHAEL LEVIN

Rephael Levin është regjisor dhe redaktues filmi, ish-nxënës i Shkollës së Filmit dhe Televizionit Sam Spiegel, Jeruzalem. Debutimi i tij dokumentar A CRIM CLELED MAN (2016) mori pjesë në Festivalin e Filmit Docaviv dhe në shumë festivale të tjerë në nivel global.





SHFAQJA E FILMIT "ZGJOI" / KS

📅 **Data:** 03 TETOR, 2021 – E DIEL

🕒 **Ora:** 20:00 – 21:30

📍 **Vendi:** KINO ARMATA

Aktorët: YLLKA GASHI, ÇUN LAJÇI, AURITA AGUSHI, KUMRIJE HOXHA ETJ.

Regjisore: BLERTA BASHOLLI

Producent: YLL UKA

Në filmin "Zgjoi" regjisorja Blerta Basholli është frymëzuar nga historia e vërtetë e Fahrrije Hotit, një nënë beqare, e cila shumë vite pasi burri i saj zhduket, detyrohet nga nevoja ekonomike të përballojë humbjen e tij. Në vend që të përqëndrohet në udhëtimin e saj emocional, Basholli krijon një histori gjithëpërfshirëse, krejtësisht klasike për të kapërcyer fatkeqësitë rreth asaj se si ajo del nga vendbanimi i fshehur, del nga shtëpia dhe gjen një punë që do të mbajë familjen e saj.



BLERTA BASHOLLI

Blerta Basholli është shkrimtare/regjisore me një stil unik realist vizual. Historitë e saj prekin çështje sociale dhe gjinore nga vendi ku ajo lindi dhe u rrit, Kosova dhe më gjerë.

Në vitin 2008 ajo u dha me Bursën e Dekanëve në Programin e Diplomimit të Filmit në Tisch School of the Arts - NYU. Ajo jetoi në New York për katër vjet ku pati mundësinë të punonte në disa projekte filmike si studente.

Në vitin 2011, ajo u kthye në vendlindjen e saj, Prishtinë, ku shkroi/drejtoi dhe punoi në shumë filma të shkurtër dhe artistikë.

Në vitin 2020 ajo përfundoi filmin e saj të parë artistik "HIVE", të cilin ajo e ka shkruar dhe drejtuar bazuar në një histori të vërtetë. Hive u shfaq në Festivalin e Filmit Sundance 2021 si pjesë e Konkursit Dramatik të Kinemasë Botërore dhe bëri histori duke fituar tre çmime, Çmimin e Jurisë së Madhe, Regjia më e mirë dhe Çmimi i auditorit. Filmi i parë që fitoi të tre çmimet në këtë konkurs në Sundance. Disa nga filmat tjerë të saj janë: "Lena & Me", "Gjakova 726", "Mirror, mirror...".

YLLKA GASHI

Yllka Gashi lindi më 30 Gusht, 1982 në Prishtinë. Është aktore e mirënjohur kosovare e diplomuar në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Për opinionin e gjerë njihet sidomos për angazhimin e saj në serialin Familja Moderne, në RTK, përkatësisht me rolin e saj Zana, me të cilin gëzon një famë të madhe publike. Ajo ka luajtur po ashtu edhe në shumë filma të tjerë të zhanreve të ndryshme, duke u prezantuar me shumë suksese, prandaj është aktore shumë e kërkuar dhe e pëlqyer posaqërisht për publikun kosovar. Në vitin 2004 ka marrë çmimin për aktoren më të mirë në Festivalin për Teatër "Setkani/Encounter" në Çeki.

ÇUN LAJÇI

Çun Lajçi ka lindur më 18.12.1946 në Drelaj të Rugovës. Shkollën tetëvjeçare në Drelaj, Normalen në Prizren dhe shkollën e Lartë Pedagogjike-Dramën në Prishtinë. Nga 1970 punoi si aktor i rregullt në Teatrin e Prishtinës. Luajti mbi 200 role në Teatër dhe 30 filma artistik. Dy herë u shpall aktori më i mirë i Serbisë në Takimet Teatrore "Joakim Vujiq". Në festivalin e teatrit "Prishtina Fest" u shpall aktori më i mirë me shfaqjen "Hëna prej letre" në regji të Fadil Hysajt. Nga Ministria e Kulturës mori çmimin e karrierës. Gjithashtu nga presidenca e Shqipërisë ka marr çmimin e "Naim Frashërit". Ka botuar dy përmbledhje poezish "Zjarr i pa shuar" dhe "Fjalës nesër i bëhet vonë".

AURITA AGUSHI

Aurita Agushi u lind në Gjilan, Kosovë më 24.10.1975. Shkollimin e ulët dhe të mesëm e kreu në vendlindje, ndërsa studimet i kreu në vitin 2003 në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arteve, dega Aktrim në klasën e prof. Enver Petrovci. Është e njohur për punën e saj në teatër, film dhe tv shows.

KUMRIJE HOXHA

Kumrije Hoxha lindi më 1953 në Prishtinë, Kosovë. Krahas përvojës në teatër, Hoxha është gjithashtu e njohur edhe për filmat "Martesa" (2017), "Mbretëria" (2017) dhe "Hive" (2021).

DITA 4:

PUBLIKIM I RAPORTIT HULUMTUES & KONFERENCA “ADRESIMI I SEKSIZMIT, NGACMIMIT DHE NGACMIMIT SEKSUAL NË KOSOVË” / KS

📅 **Data:** 04 TETOR, 2021 – E HËNË

🕒 **Ora:** 10:00 – 15:00

📍 **Vendi:** SALLA 506, KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVË & LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Autore: ARIANA QOSAJ - MUSTAFA

Moderatore: NERTILA QARRI-GËRGURI

Seksizmi zakonisht lidhet me rolet e grave dhe burrave në shoqëri dhe gjithashtu me besimet rreth roleve themelore të grave dhe burrave. Ato manifestohen si stereotipe gjinore dhe duke qenë paragjykime të ndërgjegjshme ose të pavetëdijshme, ato i ulin gratë më shpesh në statuse të caktuara në shoqëri duke renditur njëri-njërin gjini mbi tjetrën. Mund të prekë të gjithë, por më shpesh gratë preken. Ndërsa mbizotërojnë qëndrimet seksiste, praktika dhe sjellje të tilla kanë qenë një kontribues i konsiderueshëm në pozicionin e grave në shoqëri, si dhe kanë kontribuar në pabarazitë e ndryshme me të cilat përballen gratë.

Gratë vazhdojnë të jenë të nënperfaqësuar në vendimmarrje si dhe në sektorin e ekonomisë dhe vazhdojnë të jenë kryesisht përgjegjëse për kujdesin në shtëpi dhe kujdesin e paguar të punës, paguhen më pak në krahasim me burrat veçanërisht në sektorin privat dhe janë ndër numrat mbizotërues të dhunës në familje të raportuar rastet dhe aktet e tjera të dhunës me bazë gjinore. Nevoja për të trajtuar seksizmin, normat dhe sjelljen seksiste dhe fjalimin seksist është e nënkuptuar në një numër instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale.

Raporti ynë hulamtues “Adresimi i seksizmit, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në Kosovë” synon të trajtojë më tej temën dhe të paraqesë situatën aktuale mbi këtë çështje në Kosovë.

Konferenca e organizuar me rastin e publikimit të këtij raporti do të shërbejë si një platformë për të paraqitur gjetjet preliminare dhe rekomandimet që dalin nga raporti hulamtues dhe do të pasohet nga diskutime në tre panele të veçanta mbi temat:

Paneli 1: “Reagimi institucional dhe shoqëror ndaj seksizmit”

Paneli 2: “Gratë në politikë dhe seksizmi në politikë”

Paneli 3: “Seksizmi në kulturë dhe media”



ARIANA QOSAJ-MUSTAFA

Ariana Qosaj-Mustafa është analiste e lartë, feministe dhe aktiviste e të drejtave të njeriut me më shumë se njëzet vjet përvojë në fushat e lartpërmendura. Ajo aktualisht po jep mësim në Riinvest International në programet e London School of Economics të akredituara nga Universiteti i Londrës në Prishtinë, Kosovë. Ajo së fundmi është bashkuar me Universitetin Amerikan në Kosovë si pedagoge shtesë me kohë të pjesshme në politikën publike. Ajo ishte pjesë e menaxhmentit të lartë të KIPRED. Është kryetare e Rrjetit të Grave të Kosovës nga viti 2014-2021. Ajo ka publikuar një numër të analizave të politikave dhe raporteve kërkimore për KIPRED dhe Rrjetin e Grave të Kosovës në lidhje me Qeverisjen e Mirë, Sundimin e Ligjit dhe të Drejtat e Njeriut si dhe raporte që lidhen me Analizën Gjinore, Dhunën me Bazë Gjinore dhe Çështjet e Grave, Paqen dhe Sigurinë.

Edukimi i saj përfshin një diplomë Master Shkencor në Gjini, Zhvillim dhe Globalizim nga London School of Economics and Political Science, University of London-UK dhe një diplomë Bachelor i Drejtësisë nga Universiteti i Prishtinës. Ajo kohët e fundit ka mbrojtur thirrjen e saj si Doktoreshë e Drejtësisë nga Fakulteti Juridik “Iustinianus Primus” në Shkup, IRJ të Maqedonisë. Ajo ka kryer kërkime në Kolegjin e Drejtësisë në Uashington, Uashington DC nga Prilli deri në Maj 2010. Nga Shtatori 2017 deri në Dhjetor 2017 ajo ndoqi një program të certifikimit të diplomuar në Studimet e Grave, Gjini dhe Seksualitetit me Universitetin Dartmouth, Hannover USA. Ajo u diplomua me nderime të larta.



PUNËTORIA “ÇFARË ËSHTË SEKSIZMI DHE SI TA NJOHIM ATË NË JETËN E PËRDITSHME DHE MEDIAT” & “TEKNIKAT E TEATRIT BASHKËKOHOR” / SRB

📅 **Data:** 04 TETOR, 2021 – E HËNË

🕒 **Ora:** 10:00 – 14:00

📍 **Vendi:** TEATRI ODA

Trajnere: MAJA MITIĆ DHE BRANISLAVA JOVANOVIĆ

Seksizmi online është i shfrenuar në të gjithë Evropën, e më të prekurat janë gratë - veçanërisht gratë dhe vajzat e reja, gazetaret, politikanet, figura publike dhe gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut. Arti dhe kultura kanë rol vendimtar në formësimin e qëndrimeve dhe roleve gjinore, kështu që janë vendimtar për të luftuar seksizmin në këto fusha. Përveç kësaj, në përputhje me Konventën e Stambollit, kultura, feja, zakoni ose tradita nuk duhet të shihen si një justifikim për aktet e dhunës kundër grave dhe vajzave. Pjesa e parë e punëtorisë do të udhëhiqet nga psikologjia dhe gazetarja Branislava Jovanovic, dhe ka të bëjë me atë se si të njohim seksizmin në media dhe si të përmirësojmë situatën në komunitetin tonë lokal. Pjesën e dytë do ta vazhdojë artistja e teatrit Maja Mitic dhe cila do të përdorë teknikën e teatrit për të fuqizuar trupin dhe zërin që të përdoren në jetën e përditshme.

MAJA MITIĆ

Maja Mitic (1963) e diplomuar në Akademinë e Artit dhe Dramës (1988), Novi Sad, Serbi.

Për më shumë se 30 vjet duke punuar profesionalisht në teatër si aktore, koreografe, regjisore, krijuese filmi, dramaturge dhe profesore vizitore.

BRANISLAVA JOVANOVIĆ

Branislava Jovanovic (13.9.1978.), Fakulteti Filozofik, Nish, Departamenti i Psikologjisë. Punon si gazetare, krijuese e fushatave PR dhe organizatore e ngjarjeve. Në prodhimin e saj, ajo është autore e disa serive të shfaqjeve televizive në lidhje me kulturën dhe historinë e Nishit. Kryetare e Shoqatës “Rrjeti i Ri” i cili zbaton projekte të ndryshme për forcimin e shoqërisë civile përmes kulturës, arsimit, mediave, promovimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Organizatore dhe PR program në Festivalin Ndërkombëtar të Xhazit në Nisville dhe Festivalin e Teatrit në Nisville (Nish). Fituese e “Njohjes për kontributin në rritjen e ndërgjegjësimit për ekologjinë” në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Turistik dhe Mjedisor “Vrmdža fest 2021.”, (Vrmdža, Serbi) për punën si bashkëautore në dokumentarin “Pastruesit”.

MURALI “SHQIPONJA DYKRENARE”/ KS

📅 **Data:** 04 TETOR, 2021 – E HËNË

🕒 **Ora:** 17:00 – 17:30

📍 **Vendi:** PRISHTINË & LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Artiste: ERMIRA MURATI – ORANGE GIRL

Shqiponja dy KRENAre

Shqiponjat dy krenare janë vajza/gra krenare çdo ditë, çdo javë dhe muaj të çdo viti.

Krenare që janë vajza dhe gra!

Ndër vite shqiponja është paraqitur e përdorur duke i inkuadruar burrërinë, jo vetëm konceptuale, por edhe strukturore - shqiponja me muskuj dhe elemente tjera tendencioze dhe patriarkale në qasje, duke i mohuar kështu feminitetin e saj që shpërfaqet pikësisht nga emri.

Duke çmitizuar mendësinë seksite, ne e nxjerrim në pah gjenezën patriarkale, fuqinë dhe elegancën e saj, anën femërore dhe rolin e gruas në ndërtimin e kombit shqiptar – të mohuar ndër vite.

Po, shqiponjat dy krenare kanë gjokse dhe vaginë, thonjë e qerpikë dhe janë krenare për gjininë, seksualitetin dhe orientimin seksual të tyre.

Ky intervenim vjen si revoltë ndaj mendësisë patriarkale që i mvishet flamurit, jo vlerave kombëtare që i përfaqëson.

Refuzojmë që ngjyra e kuqe të na simbolizojë vlerën tonë në atë “çarçaf” që ngritet dhe valëvitet nga burrat patriarkal që dhunojnë, shtypin e vrasin vajzat dhe gratë.

Ngjyra e flamurit tonë le të mbetet ngjyra portokalli si revoltë që kundërshton dhunën ndaj nesh.

Rreth flamurit të përbashkuar me shumë qëllime dhe shumë dëshira! Qëndrojmë krenare, me njëra tjetrën të dashuruara, si dy shqiponja krenare në flamur.



ERMIRA MURATI

Ermira (Orange Girl) Murati, është një artiste vizuale që krijimtarinë e saj artistike e zhvillon përmes pikturës dhe muraleve.

Që nga moshën 13 vjeçare Ermira ka qenë pjesë e shumë ekspozitave kolektive duke ekspozuar artin e saj në galeri të ndryshme dhe duke e paraqitur atë edhe jashtë ambienteve të mbyllura të galerive - përmes muraleve nëpër hapësirat e jashtme të shume qyteteve në Kosovë.

Ermira identifikohet si artisja që në artin e saj përdor ngjyrën portokalli në shumicën e veprave e që synon që, përmes veprave të saj artistike, të sjellë ndryshime në shoqërinë Kosovare duke promovuar diverzitetin shoqëror në demokratizim dhe duke provokuar me heretizëm në tema tabu.



ARTISTET QË NA MUNGOJNË

MBRËMJA PËRKUJTIMORE “ARTISTET QË NA MUNGOJNË” KUSHTUAR NEXHMIJE PAGARUSHËS, LEZE QENËS, SHAHINDERE BËRLAJOLLIT, VIOLETA REXHEPAGIQIT / KS

 **Data: 04 TETOR, 2021 – E HËNË**

 **Ora: 18:00 – 20:00**

 **Vendi: GALERIA PAPER & LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK**

Folëset/it: LULE PAGARUSHA, MINIRE FETAHU, ARMOND MORINA, ASTRIT STAFAI

Moderatore: ZANA HOXHA

Këngëtar: ARDIT STAFAI

Violonçel: ADOREL HAXHIJAJ

Piano: FATJON MIFTARI

Lokacioni: GALERIA PAPER, TRANSMETIM ONLINE FEMART UEB DHE FACEBOOK, RADIO PAPER

Ato kanë guxuar. Ato kanë thyer barriera. Ato kanë ndryshuar mendësi dhe kanë emancipuar një shoqëri përmes artit të tyre. Zëri i tyre ka depërtuar përtej shoqërisë me shtrirje të gjerë patriarkale. Ato kanë qenë dhe mbeten udhërrëfyese të shumë vajzave e grave. Ato kanë rrëzuar mite dhe kanë thyer tabu se si janë perceptuar gratë, duke u ngritur në piedestalin e skenës së muzikës dhe teatrit.

Nexhmije Pagarusha, Shahindere Bërlajolli, Leze Qena e Violeta Rexhepagiqi janë ikona të artit shqiptar, por përtej kësaj janë gra që inspirojnë.

Në nderim e vlerësim të tyre FemArt i kujton sot e përbot.

NEXHMIJE PAGARUSHA (7 MAJ 1933 – 7 SHKURT 2020)

“Për jetën e saj qarkullojnë shumë rrëfime, legjenda e tregime, por çfarë mbetet dhe do të çmohet përjetësisht jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha viset shqiptare është - zëri i saj. Ajo e bëri muzikën të rëndësishme për të gjithë në Kosovë, e nxori atë nga odat e burrave. Por, në historinë e Kosovës ajo ka hyrë jo vetëm si këngëtare. Ajo ishte zëri emancipues i Kosovës. Në kohërat kur patriarkalimi në shoqërinë kosovare ishte edhe më i shtrirë se sot, ajo u ngjiti në skenë dhe rrëzoi shumë mite, konvenca dhe të ashtuquajtura «tradita» e tabu. Ajo inspiroi shumë gra, ajo me këngët e saj dha këtë porosi: emancipimi është i mundur, çlirimi po ashtu. Dhe çlirimi fillon me një këngë”.

©Enver Robelli / ©KOHA / <https://bit.ly/3zubnFO>

SHAHINDERE BËRLAJOLLI-STAJAJ (07 GUSHT 1946 – 3 MAJ 2020)

Se dekadat e ardhshme do t'i takonin asaj, Shahindere Bërlajolli-Stafaj e kishte dëshmuar qysh në moshën 13 vjeçare në festivalin “Mikrofoni është i juaji” ku kishte rrëmbyer çmimin kryesor. Ajo kultivoi për më shumë se 50 vjet muzikën e mirëfilltë shqiptare, duke qenë një ndër gratë që i dha identitet kulturës dhe artit në Kosovë. E rritur nën përkujdesin e nënës së saj, Shahindere Bërlajolli-Stafaj u bë pikërisht njëra nga gratë që inspiroi e traso i rrugën për gjeneratat pasuese. Me 280 këngë në repertorin e saj ajo mbetet një ndër ikonat e muzikës shqiptare.

LEZE QENA (1 MARS 1935 – 25 MARS 2020)

Humori, gëzimi e të qeshurat që përcillte tek publiku e kanë bërë të paharrueshme Leze Qenën dhe artin e saj. Atë e ka karakterizuar guximi për të sjellë komiken në skenën e teatrit, në film e në seriale. Një aktore që me karizmin, energjinë e sharmin e saj diti të jetonte dhe mësoi të tjerët të jetojnë. Me angazhimin e saj për më tepër se gjysmë shekulli Leze Qena ia përkushtoi jetën e saj teatrit dhe publikut, argëtimit e punës për emancipim shoqëror.

VIOLETA REXHEPAGIQI (21 SHKURT 1965 - 16 PRILL 2020)

Violeta, pa dyshim që ishte ndër gratë që sfidoi të gjitha normat shoqërore dhe mentalitetin e kohës. Muzika e saj përveçse na edukoi shpirtin edhe na dha mësim të vjera se si gratë duhet të ndiqnin ëndrrat e tyre. Stili i saj avangardë në muzikë e veshje ishte ajo që e bënë të veçantë kompozitoren, këngëtare e gazetaren Violeta Rexhepagiqi, e cila shihet si shembull i rebelimit artistik. Violeta ka frymëzuar dhe do të frymëzojë shumë gjenerata. Ajo është grua që shkroi vet historinë.

FOLËSIT/ET



MINIRE FETAHU

Emri i Minire Fetahut është i njohur në mjediset e artit dhe të kulturës shqiptare jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Me punën dhe profesionalizmin e saj si gazetare dhe redaktore ajo ka kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe artit muzikor. Ajo është autore e dhjeta emisioneve argëtuese, popullore, reportazheve si dhe dokumentarëve. Me angazhimin e saj përgjatë dekadave ajo ishte pranë artit e kulturës, duke bashkëpunuar nga afër me emra të mëdhenj të muzikës dhe artit shqiptar por edhe botëror, për t'i sjellë rrëfimet e tyre pranë publikut.



ARMOND MORINA

Armond Morina lindi më 22 dhjetor 1973 në Gjakovë, Kosovë. U diplomua më 26 shtator 1996 në Akademinë e Arteve në Prishtinë, Aktrim. Ai aktroi, shkroi dhe

prodhoi filma të metrazhit të shkurtër dhe të gjatë në Kosovë. Morina është një nga aktorët më të shquar të skenës së teatrit, filmit dhe serive në Kosovë, me përvojë të gjatë të shfaqjeve teatrore në Teatrin Kombëtar të Kosovës, në Teatrin Dodona e atë të Qytetit të Gjakovës.




ASTRIT STAJAJ

Astrit Stafaj është i lindur më 1980 në Prishtinë. I rritur në një familje artistësh ai dëshmoi talentin e tij qysh në moshë të re. Ai është muzicent eksperimental, kitarist dhe multi-instrumentist virtuoz i përmasave ndërkombëtare. Edhe pse është i fokusuar më shumë në zhanrin Ethno World Music atë e gjejmë gjithnjë në projekte dhe koncerte të ndryshme muzikore si rajonale ashtu edhe ndërkombëtare. Ai është prezantuar në shumë festivale e projekte artistike, duke rrëmbyer edhe çmime prestigjioze për interpretimet e tij unike.



FLORIJE LULE PAGARUSHA

Florije Lule Pagarusha e lindur në Pejë është redaktore në RTK. Ajo është e diplomuar në shkencat sociale. Me një përvojë të gjatë në media Pagarusha është autore e bashkautore e shumë emisioneve televizive dhe filmave dokumentarë. Ajo shquhet gjithashtu për punën e saj si trajnere për lidërsip, çështje gjinore, paraqitje para publikut, të drejta të njeriut, komunikim dhe aftësi udhëheqëse.



SHFAQJA E PERFORMANCËS "GJUETARET E ARTEMIDËS" / KS

- 📅 **Data:** 04 TETOR, 2021 – E HËNË
- 🕒 **Ora:** 20:00 – 21:00
- 📍 **Vendi:** LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Regjisore: ZANA HOXHA

Artistët: AURITA AGUSHI, SEMIRA LATIFI, DONIKË AHMETI, DANIELA MARKAJ, QENDRESA KAJTAZI, HAJAT TOÇILLA DHE FITORE JASHARI

Inspiruar nga natyra dhe bukuritë e fshatit Kukaj, aty ku hapësira dhe çdo gjë që e rrethon këtë ambient është në harmoni me tokën dhe qiellin, nisi një tregim i jashtezakonshëm i performancës "Gjuetaret e Artemidës". Ky proces krijues filloi nga një vizitë në natyrën e qetë, që ishte shërim për trupin dhe shpirtin, e që e frymëzoi regjisoren Zana Hoxha, të krijojë një vepër që është në përputhje me natyrën si perëndeshë shëruese, burim i jetës dhe energji e pashtershme. "Gjuetaret e Artemidës" dalëngadalë u formësua duke personifikuar shpirtin e një gruaje të pavarur duke bërë rritualin pagane dhe duke dhënë dashuri e solidaritet në harmoni me natyrën.



ZANA HOXHA

Zana Hoxha (e lindur më 1981) është regjisore profesionale e teatrit, themeluese dhe drejtoreshë ekzekutive e Qendrës për Art dhe Komunitet – Artpolis, organizatë kjo që promovon artin dhe diversitetin me dialog social dhe integrim të komunitetit.

Ka krijuar më shumë se 20 performanca teatrale të cilat janë prezantuar në tetret më të mëdha të Kosovës, në regionin e Ballkanit (Shqipëri, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, Kroaci), njëherësh ka prezantuar punën e saj si artiste/aktiviste/trajnere edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Evropë, Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut.

Zana ka qenë drejtoreshë e Departamentit të Teatrit në festivalin SKENA UP gjatë viteve 2004-2011, Drejtoreshë artistike e Teatrit Profesional gjatë vitit 2011-2014, gjithashtu Themeluese dhe Drejtoreshë e festivalit më të madh feminist në Ballkan të artisteve dhe aktivisteve, FEMART.

Po ashtu, ajo është e përzgjedhur si IVLP Alumini (Programi Ndërkombëtar për vizitorët e huaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe fituese e shumë çmimeve për kontributin si regjisore në Kosovë dhe rajon.

Duke kombinuar artin dhe aktivizmin ajo përdorë teatrin si mënyrë avokuese për të drejtat shoqërore që fokusohen në rritjen e vetëdijes lidhur me dhunën e bazuar në gjini, të drejtat e njeriut dhe diversitetin.

Ajo është krenare që është pjesë e bordit të Rrjetit të Grave të Kosovës, ligjëruese dhe trajnere e specializuar në Forum Teatër dhe përkrahëse në fuqizimin dhe emancipimin e grave aktiviste.

DITA 5:

PUNËTORI PËR VETËMBROJTJE “ÇIKAT E SJELLSHME” / KS

📅 **Data:** 05 TETOR, 2021 – E MARTË

🕒 **Ora:** 11:00 – 13:00

📍 **Vendi:** AKADEMIJA E ARTEVE MARCIALE
PRISHTINA

Trajner: NUHI GASHI


Rëndësia parësore e vetëmbrojtjes padyshim është që gratë, por jo vetëm ato, të jenë në gjendje të mbrojnë veten nga çdo gjë që është e papranueshme në aspektin e sjelljes shoqërore. Tutje, vetëmbrojtja ju ofron atyre që e praktikojnë besim për të analizuar një situatë të rrezikshme dhe për të ndërmarrë veprime për t'i kapërcyer ato në mënyrë efektive. Poashtu, ky aktivitet fuqizon gratë (dhe burrat) që të bëjnë një jetë të shëndetshme dhe të kënaqshme duke i inkurajuar që të merren me situata stresuese dhe të rrezikshme në mënyrë të pavarur



NUHI GASHI

I lindur më 23.09.1972 në Prishtinë. Dëshira e madhe e tij për sporte e në veçanti për Arte Marciale e bënë që ai të studiojë Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit. Me Arte Marciale ka filluar fillimisht në shtator të vitit 1989. Përgjatë këtyre viteve Nuhiu ka punuar dhe vepruar në përhapjen e Taekwondo-së, në masovizimin e këtij sporti, në ngritjen e cilësisë së garuesve si në garat vendore ashtu edhe në ato ndërkombëtare, në edukimin e të gjithë studentëve të tij atj, ai gjithashtu ka stërvitur edhe në shumë arte marcialë siç janë: kick boks, karate, Aikido, jiu jitsu, hapkido, ëing tchun, vetëmbrojtje, MMA etj, dhe deri më tani ai ka stërvitur më së paku me 15

trajnerë të arteve marcialë. Në vitin 2008 tehemeloi Akademinë e Arteve Marciale “Prishtina”. Nuhiu, me një përvojë prej 32 vjeçare në Arte Marciale vazhdon të punojë dhe trajnojë kategori të ndryshme, që nga fëmijët 4 vjeçar e lartë.



PODCAST “ART PËR SH’NET” / KS

📅 **Data: 05 TETOR, 2021 – E MARTË**

🕒 **Ora: 15:00 – 16:00**

📍 **Vendi: LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK**

Autore: URESA AHMETI

Folësit: DORENTINA PODRIMQAKU DHE ARDIJAN KRASNIQI

A jeni ndal me mendu për shëndetin tuaj mendor, emocional e fizik? Si ndërlidhet arti me shëndetin tuaj? Në këtë episod, të ftuarit tanë, një psikologe dhe një aktivist flasin për fuqinë e artit për të arritur mirëqenie individuale dhe kolektive.

DORENTINA PODRIMQAKU

Dorentina Podrimqaku ka përfunduar studimet në nivelin bachelor në degën e Psikologjisë në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës.

Ajo ka zhvilluar një interes të hershëm në psikologjinë klinike ndërsa punonte vullnetarisht me fëmijë me çrregullime. Krahas arsimimit të saj, ajo punoi në Spitalin Universitar dhe Shërbimin Klinik të Kosovës. Për dy vitet e fundit, ajo ishte zëvendës drejtore e “Qendra për Informim dhe Përmirësim Social” dhe gjithashtu u përqëndrua në Menaxhimin e linjës telefonike “Linja e Jetës” ku u përfshi në adresimin e nevojave të vullnetarëve dhe organizatave, ndërsa organizoi dhe menaxhoi aktivitete kulturore dhe sociale në përputhje me rrethanat, duke punuar drejt një të ardhme më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse.

ARDIJAN KRASNIQI

Ardijan Krasniqi vjen nga komuna e Fushë Kosovës, është 17 vjeçar, dhe i përket komunitetit Egjiptian, nxënës i shkollës së mesme. Aktivist i ri për të drejtat e komuniteteve Romë, Ashkalinjë, dhe Egjiptian. Po ashtu dhe vullnetar në organizatën Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), dhe merret me shfaqje teatrale.



PERFORMANCA TEATRALE "DETI/ GRUAJA" / MB-SRB

📅 **Data: 05 TETOR, 2021 – E MARTË**
🕒 **Ora: 17:00 – 18:00**
📍 **Vendi: TEATRI ODA & LIVESTREAM NË
UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK**

Regjisore: ANNA FURSE
Aktore: MAJA MITIĆ

Zonja nga Deti ka të bëjë me një interpretese që kërkon diçka të papërcaktueshme. E shqetësuar, e shtrënguar, ajo zhytet vazhdimisht në tekstin e saj për të harruar veten dhe për t'u bërë Ajo - por shfaqet duke kujtuar edhe më shumë. Çfarë rrënojash po gjen ajo atje poshtë?

"E freskët? I dashur Zot, uji këtu nuk është kurrë i freskët. Është i pajetë dhe i ndernjur. Uh! Uji është i sëmurë këtu në fiord ... Po, i sëmurë. Mendoj se mund të të bëjë të sëmurë. Po ashtu helmues..."
H. Ibsen

ANNA FURSE

Anna Furse është një regjisore, shkrimtare dhe dramaturge fituese e çmimeve të mbi 60 veprave, përfshirë komisionet ndërkombëtare. Profesore e Teatrit dhe Performancës në Goldsmiths, Universiteti i Londrës, ajo drejton MA ndërkombëtar në Krijim të Performancës. Veterane udhëheqëse e projekteve dhe ligjëruese ndërkombëtare, ajo është një folëse e shpeshtë e

ftuar në konferenca ndërkombëtare. Ajo bashkë -themloi trupën eksperimentale feministe BloodGroup në 1981, dhe vendin e vallëzimit Chisenhale në 1980. Si Drejtore Artistike e Paines Plough (1990 - 1995) ajo ishte pioniere e shkrimtarëve që punonin me kompani vallëzimi, në praktika specifike dhe gjithëpërfshirëse, dhe në Artin Live.



MAJA MITIĆ

Maja Mitic (1963) e diplomuar në Akademinë e Artit dhe Dramës (1988), Novi Sad, Serbi.

Për më shumë se 30 vjet duke punuar profesionalisht në teatër si aktore, koreografe, regjisore, krijuese filmi, dramaturge dhe profesore vizitore.





MBRËMJA E PROMOVIMIT TË LIBRIT DHE POEZISË “SHKRIMI SI NJË MJET PËR TË SHKATËRRUAR PATRIARKATIN” / SHQIPËRI – KOSOVË - SHBA

📅 **Data:** 05 TETOR, 2021 – E MARTË

🕒 **Ora:** 18:00 – 20:00

📍 **Vendi:** TEATRI DODONA & LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Autore: RITA PETRO, ILIRE ZAJMI, SHQIPE MALUSHI

Mysafiret tona të mbrëmjes së promovimit të librit dhe poezisë e dëshmojnë më së miri moton e kësaj mbrëmjeje përmes veprave të tyre, jo vetëm letrare. Ato guxuan dhe shkruan ndjenjat e tyre, historitë personale dhe të tjerëve, guxuan dhe shkruan për tema që nuk “guxohej” as të diskutohej. Ato përdorën shkrimin për t’i lënë trashëgim shpirtin e tyre brezave të ardhshëm. Por mbi të gjitha, për t’iu dëshmuar të tjerëve se jeta duhet të jetohet sipas dëshirës tënde, e jo sipas rregullave të patriarkatit.

ILIRE ZAJMI

Ilire Zajmi (1971), shkrimtare, gazetare, studiuese. Autore e gjashtë vëllimeve me poezi, katër të botuara në gjuhën shqipe “Këmbanat e mëngjesit”, “Baladë e bardhë”, “Valsi i mesnatës”, “Vjeshta është grua”, një në gjuhën angleze “Amnesia” dhe një në gjuhën frengje “Ce la fin”. Autore e romaneve “Fashitja e ëndrrave rebele”, “Era” + “Një luftë e pakryer”, librit publistik “Un treno per Blace” botuar në Itali, të përkthyer në shqip “Një tren për Bllacë” dhe në kroatisht “Vlak za Blace”, si dhe librit studimor “Pamjet televizive dhe realiteti”.

Poezitë e Zajmit janë përkthyer e botuar në disa gjuhë të huaja. Ajo gjithashtu ka marrë pjesë në disa festivale ndërkombëtare të letërsisë.

RITA PETRO

Rita Petro (Filipi), e lindur në Tiranë, më 13 mars 1962; e diplomuar për Letërsi e Gjuhë Shqipe në Universitetin e Tiranës; e specializuar për Filozofi e Kulturë greke në Universitetin Filozofik të Athinës (1993); me profesion specialiste didakte për lëndën e Gjuhës e të Letërsisë në shkollë; bashkëautore në 40 tekste shkollore, drejtoreshë dhe bashkëthemeluese e shtëpisë botuese Albas, një prej kompanive të njohura të botimit me degët e saj në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe në Preshevë; me një kontribut të njohur në poezinë bashkëkohore shqipe për frymën “skandaloze”, kontraversale; pjesëmarrëse në disa festivale poetike brenda dhe jashtë vendit.

SHQIPE MALUSHI

Shqipe Malushi është një shkrimtare, poete, interpretese, folëse publike, këshilltare gjinore, një trajnere e fuqizimit dhe trajnere e lidërshipt, duke përdorur tregimin për të rritur ndërgjegjësimin, ndërtimin e lidërshipt dhe ndërtimin e paqes përmes çështjeve ndërkulturore. Me origjinë nga Kosova, ajo lëvizti duke u transformuar nga një emigrante në një qytetare botërore.

Tregimet e saj janë botuar ndërkombëtarisht dhe përfshijnë një libër me poezi "Për Ju", në shqip; dhe "Dhurata e Profetëve" në anglisht; "Sekreti i ëndrrave" dhe "Përtej mureve të tokës së harruar, përralla mitologjike shqiptare siç tregohet nga gjyshja e saj!" etj.. Puna e saj për fuqizimin e grave u zgjerua përtej kufijve duke forcur marrëdhëniet në Afganistan, Liban, Irak, Indi, Kosovë, Shqipëri dhe SHBA.

FLORA DURMISHI

E lindur më 18.10. 1960, studimet universitare për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe i ka përfunduar në Prishtinë. Për 16 vjet ka punuar si pedagogje në Gjilan e Prishtinë. Si studente ka bashkëpunuar me gazetën e studentëve "Bota e Re" e cila aso kohe kishte ndikim të madh. Kjo përvojë e tërhoqi fuqishëm deri në pasion dhe që vazhdoi deri në ditët e sotme. Në vitin 1999, fillon punën në Radio Blue Sky, sot Radio Kosova. Është ndër gazetaret e para dhe autore e emisioneve të para në këtë radio. Është autore e shumë reportazheve, emisioneve të drejtëpërdrejta, debateve e intervistave të ndryshme me njerëzit e kulturës dhe te artit por edhe të politikës. Flora Durmishi është autore e emisionit të parë pas luftës që i kushtohet gruas. Ajo është luftëtare e paepur për barazinë dhe dinjitetin e gruas shqiptare. Për punën e saj është shpërblyer disa herë. Vecojmë: "Femra më e sukseshme në media" (2007), "Gruaja e Vitit" (2012) "Mbretëresha Teutë" (2013) si dhe Albanian Excellence 2019, në Tiranë.

SAFETE ROGOVA

Safete Rogova lindi në Gjakovë më 1 mars 1946. Shkollimin e ulët mbaroi në vendlindje. Në Prishtinë mbaroi Fakultetin Filozofik – gjuhë e letërsi dhe pastaj edhe Shkollën e lartë të Dramës më 1968. Nga viti 1969 filloi punën si aktore në Teatrin Kombëtar. Safete Rogova është njëra nga ato figura të shquara të jetës sonë kulturore e artistike, që imponon lakminë për një jetë kushtuar artit, skenës, familjes, humanizmit. Ka luajtur mbi 100 role të cilat do të mbushnin fletët po të flitej për to. Vitet nëntëdhjetë qenë

vite të qëndrësës, të gjetjes së formave për të mbijetuar, për të tejkaluar më të keqen, kohë kur ajo ashkë me shokun e jetës e të skenës Nuredin Loxhën si dhe me motrën Igballe Rogovën, formojnë shoqatën për arsimimin e gruas "Motrat Qiriazit". Një mision i ri, një mundësi më shumë për shpirtin e një humanisteje.

RINA KRASNIQI

E lindur më 10 dhjetor 1996 në Prishtinë, Rina Krasniqi konsiderohet si një nga aktoret më të reja premtuese të Kosovës dhe Evropës Lindore. E lindur në industrinë kulturore, ajo trashëgoi talentin dhe interesin e saj për artin nga prindërit e saj. Ajo filloi të aktojë, interpretojë dhe këndojë qysh në moshën dyvjeçare. Ajo vazhdoi studimet për aktrim dhe regji në Fakultetin e Arteve Dramatike në Prishtinë. Që nga diplomimi, ajo është luajtur në role kryesore për prodhimet ndërkombëtare dhe ka punuar me disa aktorë dhe regjisorë të njohur. Përveç aktrimit, ajo është një këngëtare dhe muzikante e trajnuar. Ajo ka marrë "Çmimin më të mirë MonoStrip" në Festivalin Ndërkombëtar të Monodramës në 2017 dhe "Yjet e Rritjes së Kosovës" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Prishtinë 2019 (PriFest). Ajo konsiderohet si një nga aktoret e reja më premtuese jashtë Kosovës dhe Evropës Lindore.



PERFORMANCË DANS TEATËR “TOTEM DHE TABOO”

📅 **Data:** 05 TETOR, 2021 – E MARTË

🕒 **Ora:** 20:00 – 21:30

📍 **Vendi:** LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Koreograf: ROBERT NUHA

Dramaturge: ZANA HOXHA

Aktorët: DONIKË AHMETI, QENDRESA KAJTAZI, ISMAIL KASUMI, EDLIR GASHI, KALTRINË ZENELI, MIKEL MARKAJ, ZHANETA XHEMAJLI, BLERTA GUBETINI

“Totem dhe Tabu”, është tandem eksperimental i dansit kontemporan dhe tekstit minimal që mundëson reflektimin e audiencës lidhur me çështjet e ngritura të cilat ngërthejnë jetën e tyre dhe mentalitetin kosovar. Performanca Dans Teatër është eshte shfaqja e parë zyrtare e Trupës Artistike Rezidente të Artpolis.

ROBERT NUHA - NOA

U lind në Komoran (Rks) 1990. Karrierën e filloi me kërcime urbane, hip hop, breake dans, si dhe me valle popullore shqiptare. U diplomua në Koreografi, Bachelor 2016 dhe Master 2019 në Universitetin e Arteve në Tiranë (AI).

Aktualisht Profesor i Koreografisë dhe Dansit Bashkëkohorë pranë Kolegjit AAB- Prishtinë.

Koreograf i Trupës artistike Rezidente pranë Qendrës “Artpolis”- Prishtinë.

Pjesë e “Albania-Dance Theatre Company”(2014-2020).
Ka marrë pjesë në një numër të madh projektsh artistike, me

artistë shqiptarë dhe të huaj, duke prezantuar punët e tij në festivale të ndryshme në gjithë Europen përfshirë: Gjermani, Itali, Zvicërr, Kroaci etj , shfaqje dansi si “Im the Men!?”(Germany), “Stress Biology”(Swiss), “Hybrid 0 to 100”(Izrael) etj... së fundi ka bashkëpunuar me kompaninë e famshme të dansit bashkëkohorë Compagne LINGA (Swiss) me shfaqjen “Between”.

Themelues i kompanisë së parë profesionale të danse-teatrit në Kosovë “Noa Dance Theatre Company”, Koordinator i festivalit internacional, i vetmi festival i dansit bashkëkohorë në Kosovë “Albania-Kosovo Dance Meeting”.

Ai gjithashtu ka luajtur në disa produksione filmike si “Bal-Kan”

(AI), "Light (U.S.A dhe AI) "Motër dhe Vëlla" (AI), "Djali dhe Blela" (AI) "Çirku Fluturues" (rks) etj. Bashkë-koreograf në shfaqje si "Lulet e Dimrit" e prezantuar në Mediterranean Yong Artists Bienale, "Lets Go" prezantuar në Teatrin kombëtar të Kosovës. Gjithashtu ai ka punuar me disa ansamble popullore në Kosovë, përfshirë edhe Ansamblin Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "Shota" në të cilën ka bashkë-koreografuar "Brezave Amanet" së bashku me koreografin e mirënjohur shqiptar Gjergj Prevazi. Ka koreografuar disa shfaqje të Teatrit si: "Destur-Blasfemi e Ëmbël" (Teatri Kombëtar), "Ferma e Kafsheve" Teatri Kombëtar i Shqipërisë, "Shumë Zhurmë për Asgjë" (Teatri Hadi Shehu-Gjakovë), "Zgjimi i Pranverës" (Teatri Kombëtar dhe Artpolis), "Gjuetaret e Artemidës", "Provo edhe njëherë Sem", "Allo Allo" etj. Koreograf i projekteve artistike si "What Men Want", "Anlimit", "Feel", "InOut", "Flux Life", "Ups and Downs", "White Night", "Totem dhe Tabu" etj.

Aktualisht është duke punuar projekte artistike në Shkup, Tiranë, Prishtinë si dhe ka ligjruar pranë Akademisë së Dansit në Letoni e gjithashtu ka pasur premierë botërore shfaqjen e tij "InOut" në festivalin prestigjioz "Laiks Dejoj" në Riga, Letoni, me të cilën u prezantua në festivalin CerModern në Ankara të Turqisë. Në krijimtarinë e tij artistike ai tenton që të gjejë shkrirje organike të valles e kërcimit popullor shqiptar me stilin e dansit kontemporan, me të cilën synon të gjejë një formë unike dhe origjinale të koreografimit dhe kërcimit!

Trupa Artistike Rezidente e Artpolis

DONIKË AHMETI

Donikë Ahmeti është aktore, performuese, producente, aktiviste. Ka luajtur me dhjetëra shfaqje teatrore duke bashkëpunuar me shumë regjisorë vendor dhe të huaj. Donika është mjaft aktive edhe në skenën televizive.

QENDRESA KAJTAZI

Qendresa Kajtazi ka përfunduar studimet për Aktrim në Fakultetin e Arteve në Universitetin Hasan Prishtina. Ka qenë pjesë e shfaqjeve, performancave, filmave, dhe serive televizive të ndryshme.

ISMAIL KASUMI

Ismail Kasumi ka lindur më 1986 në Llojanë, Kumanovë, Maqedonia e Veriut. Në vitin 2013 ai diplomoi në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Dega e Akademisë së Arteve Dramatike dhe Aktrimit në Maqedoni. Më pas, ai ndoqi studimet master në Universitetin e Prishtinës, Kosovë, ku në vitin 2018 mori diplomën Master në Akademinë e Artit - Aktrim, Film & TV.

EDLIR GASHI

Edlir Gashi nga Skenderaj i lindur më: 27.10.1994. Ka përfunduar shkollën e mesme teknike në Skenderaj për të vazhduar studimet e larta në fakultetin e Arteve Dramatike-Dega Aktrim në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Tani jeton dhe punon në Prishtinë.

KALTRINË ZENELI

Kaltrinë Zeneli ka lindur në shkurt të vitit 1995. Në korrik të vitit 2018 diplomoi në Degën e Arteve Dramatike në Universitetin e Prishtinës, tani është aktore profesionale e teatrit, dhe pjesë e Trupës Artistike të Artpolis.

MIKEL MARKAJ


Mikel Markaj - në kërkim të menyres për të shprehur më mirë atë që ndjente vendosi të ndjehet në Degën e Arteve Dramatike në Universitetin e Prishtinës. Ambicioz në zhvillimin profesional, i motivuar për të dhënë kontributin në projekte në ndihmë të komunitetit dhe i gatshëm për sfida profesionale.

ZHANETA XHEMAJLI


Zhaneta është aktore profesionale e lindur dhe e rritur në Prishtinë (14.09.1993). Interesimi i saj për art ka filluar qysh në shkollë fillore. Përveç diplomimit në Fakultetin e Artit dega - Aktrim, ajo ka përfunduar edhe shkollën e muzikës në Prenk Jakova, për këndim dhe piano. Ka marrë pjesë në shfaqje të ndryshme profesionale si dhe koncerte muzikore.

BLERTA GUBETINI

E lindur më 16.05.1997 në Vushtrri Kam diplomuar në Universitetin e Prishtinës - Fakulteti i Arteve, Dega Aktrim Aktore profesionale/rezidente në trupën artistike të Qendrës për Art dhe Komunitet - ARTPOLIS Aktore në Teatrin e Qytetit "Adem Mikullovi" Vushtrri.



DITA 6: **YOGA “YOGA ASANA DHE** **PRANAYAMA”**

 **Data: 06 TETOR, 2021 – E MËRKURE**

 **Ora: 10:00 – 12:00**

 **Vendi: PARKU I GËRMISË (AFËR VILA GËRMIA)**

Trajnere: AGNESA MEHMETI DHE RINA MEHMETI

RINA DHE AGNESA MEHMETI

Rina Mehmeti (në anën e djathtë të fotos) është mësuese e yogës dhe bashkëthemeluese e Urban Yoga studios ne Prishtine. Klasat e saja janë të fuqishme, të gjalla dhe shumë të këndshme!

Ajo ka filluar të praktikojë yogën që nga viti 2013.

Rina është mësuese e certifikuar e yogës me 200 orë të stilit Hatha Yoga në Breath of Life në Kretë, 50 orë të stilit Yin Yoga, në Arhanta Yoga Ashram të Hollandës, 85 orë të Prenatal dhe Post-Natal, Yoga nga Transformational Hatha Yoga në Toscana, Itali dhe 95 orë Yoga për fëmijë nga shkolla Yogaji në Vjenë / Austri.

Poashtu, Rina është Nutricioniste e certifikuar nga Gateway Workshops/Aboutwellness, UK.

Agnesa Mehmeti (në anën e majtë të fotos) është trajnere e yoges dhe bashkthemeluese e Urban Yoga studios ne Prishtine.

Agnesa është e certifikuar në stile të ndryshme të yogës ku përfshihen 200 orë të stilit Hatha Yoga, në Breath of Life në Kretë; 300 orë të trajnimit të avancuar Hatha dhe Ashtanga, në Yoga Mea, Misano Adriatico / Itali. 50 orë të stilit Vinyasa Yoga, në Arhanta Yoga Ashram në Hollandë dhe 85 ore Prenatal dhe Postnatal Yoga TTC ne Jogajji Viene/ Austri.

Është person frymëzues, energjike, bujare dhe e këndshme e cila ka praktikuar yoga që nga viti 2013. Tashmë, yoga është bërë pjesë e jetës së saj dhe praktika e ka ndihmuar të bëhet më e forte dhe më fleksibile, si në mat, ashtu edhe jashtë matit. Yoga e frymëzon atë për të jetuar çdo moment me më shumë vëmendje.



PODCAST “QYSH BOHET MA E MIRË E NESËRMJA?” / KS

📅 **Data: 06 TETOR, 2021 – E MARTË**

🕒 **Ora: 15:00 – 16:00**

📍 **Vendi: LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK**

Autore: URESA AHMETI

Folësit: AURITA AGUSHI DHE BLERTA BASHOLLI

Edicionin e dytë të Femart Podcast e përmbyllim duke reflektuar mbi situatën e tanishme të artit në Kosovë. Çfarë ndryshime kanë ndodhur gjatë viteve të fundit? Cilat janë problemet sociale dhe strukturore që sfidojnë punën dhe mirëqenien e artistit? Çka duhet të bëhet që të sigurohet dinjiteti i artistit në punë? Shikoni episodin e fundit ku dy artistet e ftuara ndajnë perspektivat e tyre me ne.



AURITA AGUSHI

Aurita Agushi u lind në Gjilan, Kosovë më 24.10.1975. Shkollimin e ulët dhe të mesëm e kreu në vendlindje, ndërsa studimet i kreu në vitin 2003 në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arteve, dega Aktrim në klasën e prof. Enver Petrovci. Është e njohur për punën e saj në teatër, film dhe tv shows. Shfaqje dhe role kryesore në Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe në teatrot tjera brenda dhe jashtë Kosovës si: “Fluturimi mbi Folenë e Qyqes”, “Ëndrra e Një Nate Vere”, “Romeo dhe Zhuljeta”, “Roberto Xuko”, “Lisistrata”, “Trojanet” etj. Filmat: “Kukumi”, “Tri Dritare dhe një Varje”, “Agnus Dei”, “Babai”, filma që premierat botërore i kanë pasur në festivalet “Zemra e Sarajevës”, “Karlovyvary Film festival”. Shume shpërblime dhe festivale tjera në botë. Gjithashtu vlen të theksohet se ka luajtur në filmin e shkurt “Shok” i nominuar për Oskar nga Akademia Amerikane e Filmit. Në mesin e shumë shpërblimeve për teatër dhe film si aktorja më e mirë protagoniste dhe jo protagoniste. Së fundi është nominuar për aktoren më të mirë në “Manhattan Short Film Festival”.



BLERTA BASHOLLI

Blerta Basholli është shkrimtare/regjisore me një stil unik realist vizual. Historitë e saj prekin çështje sociale dhe gjinore nga vendi ku ajo lindi dhe u rrit, Kosova dhe më gjerë.

Në vitin 2020 ajo përfundoi filmin e saj të parë artistik “HIVE”, të cilin ajo e ka shkruar dhe drejtuar bazuar në një histori të vërtetë. Hive u shfaq në Festivalin e Filmit Sundance 2021 si pjesë e Konkursit Dramatik të Kinemasë Botërore dhe bëri histori duke fituar tre çmime, Çmimin e Jurisë së Madhe, Regjia më e mirë dhe Çmimi i auditorit. Filmi i parë që fitoi të tre çmimet në këtë konkurs në Sundance. Disa nga filmat tjerë të saj janë: “Lena & Me”, “Gjakova 726”, “Mirror, mirror...”.



NATA E KABARESË FRANCEZE / KS

📅 **Data:** 06 TETOR, 2021 – E MARTË

🕒 **Ora:** 19:00 – 21:30

📍 **Vendi:** TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS & LIVESTREAM NË UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK

Këngëtare: ZANA BERISHA

Koreograf: ROBERT NUHA

Regjisore: ZANA HOXHA

Aktorët: LABINOT RACI, DANIELA MARKAJ, DONIKË AHMETI, QENDRESA KAJTAZI, EDLIR GASHI, KALTRINË ZENELI, MIKEL MARKAJ, ZHANETA XHEMAJLI, BLERTA GUBETINI

Valltarët: ALTINA BINA KU, GENTA HOXHA, EURON HYSENI, ERNA SALIHU, ILIR LOKU, IBRAHIM TUSHA, LAVDIJE IDRIZI, MEDINA KOLI QI, PATRIOT OSMANI, QENDRIM MAKOLLI

Bateri: TEOMAN UKÇA

Kitar: ARBËR SALIHU

Piano: ALZAN GASHI

Violonçelo: GRESA BROÇI

Kostumograf: ARBNOR BRAHIMI

Nata Franceze e Kabares përmes teksteve dhe koreografisë sulmon patriarkatin që imponon seksizmin në shoqëri në nivel ekonomik, politik dhe kulturor. Kjo performancë përdoret si hapësirë për reflektim mbi normat gjinore të krijuara në shoqërinë tonë që shpesh mundësojnë një hapësirë për dhunë dhe pabarazi. Përtej kësaj, performanca sjell pozitivitet dhe shpresë për të gjithë publikun, artistët, aktivistët dhe stafin që ishin të angazhuar në këtë edicion të festivalit.

ZANA BERISHA

Zana Berisha (e lindur në Belgjikë në vitin 2002) është studente në Universitetin e Arteve në Prishtinë, në degën e aktrimit njeherësh edhe koriste në korin Siparantum, poashtu edhe solo-performuese në muzikën frenge.

Në fushën e aktrimit Zana ka marrë pjesë në disa projekte filmike studentore dhe profesionale dhe vazhdon të jetë aktive në fushën e aktrimit por sa l perket muzikes Zana qe nga femijeria ishte pjese e aktiviteteve te ndryshme artistike, ku Zana tregon qe ne cdo shfaqje muzikore ajo performoi kengen e parapëlqyer te

nenes se saj "La vie en rose". Performanca kto qe Zanes l ngjallen nje dashuri te madhe per muziken frenge, dhe ne zhvillim e siper te aftesive te saj muzikore ajo gradualisht krijoi stilin e saj unik te kendimit.

Zana gjithashtu ka marrë pjesë në shumë koncerte dhe gara me korin Siparantum, brenda dhe jashtë Kosovës (Shqipëri, Mal Zi, Kroaci, Itali dhe Belgjikë) vien te theksohet se ne Belgjike ne kishen Abbaye De La Cambre Zana performoi si soliste. Zana se fundmi ka pase koncertin "Soiree francaise" ne Kinemane Jusuf Gervalla ne qytetin e Pejes.



DANS PERFORMANCA “TAONURA” / EGJIPT

📅 **Data: 06 TETOR, 2021 – E MARTË**

🕒 **Ora: 19:00 – 21:30**

📍 **Vendi: TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS & LIVESTREAM NË
UEBFAQEN E FEMART & NË FACEBOOK**

Artist: AHMED ALAA SHAFIK ELSHIKH

Vallëzimi Tanoura është një formë e të shprehurit, një mënyrë lavdërimi në natyrë që është e mbushur me aftësi dhe shenja të bukura që ndikojnë në emocionet tona në një mënyrë ose në një tjetër. Vallëzimi është pjesë e Safari -t të Aventurës Emirate Desert të realizuar si një simbol i paqes shpirtërore dhe duke u bërë një me Perëndinë, është një valle fetare me simbole të ndryshme në botën shpirtërore. Nga një perspektivë filozofike, tjerja demonstroi idenë se bota fillon në një pikë qendrore vetëm për të përfunduar në të njëjtin vend. Prandaj, ai lëviz në mënyrë rrethore.




AHMED ALAA SHAFIK ELSHIKH

Ahmed Alaa El-Sheikh është një qytetar egjiptian, ai është 28 vjeç dhe është një balerin Tanoura që nga viti 2009. Ai punoi në Emiratet e Sharjah në Emiratet e Bashkuara Arabe për një vit. Kohët e fundit ai po punon si balerin Taonura me orar të plotë në Dubai, shfaqja zgjat 15 deri në 20 minuta dhe ai është një person shumë fleksibil.

organizuar nga / organized by:



mbështetur nga / supported by:





FEMART 9

F . . . SEXISM
01-06 OCTOBER

organizuar nga
organized by:

artpolis 
art and community center